

# Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT  
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545




*The Albanian*

VITI I 21 I BOTIMIT 25 MARS 2025

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

## ÇFARË PO NDODH ME AEROPORTIN E KUKËSIT?



PETRIT KUÇANA

**KUSH I 'NGRIU'  
FLATRAT E  
VERIUT?**



ARBEN MANAJ

**KRYEMINISTRI STARMER  
BËN SHKURTIME NË  
SHËRBIMIN  
SHËNDETËSOR  
TË NGJASHME  
SI ELON MUSK NË SHBA**


**TË DREJTOSH ODËN  
EKONOMIKE  
KOSOVARO-BRITANIKE**

ARTAN LLABJANI



**ERËRAT QË  
PO FRYJNË  
NË EUROPE**

DITMIR BUSHATI



**VLERËSIM PËR  
VEPRËN E  
BEJTULLAH DESTANIT**

MAL BERISHA



**NARKODILERËT  
I PRODHON  
"JOVANJICA" JO TËRNOCI**

SHAIP KAMBERI




**PUTINI, TRUMPI  
DHE PLATONI  
RIVIZATOJNË EVROPËN**

VETON SURROI



*Perfumes, Edd,  
Bath & body, Deodorants*



MY  
PERFUMERY

WWW.MYPERFUMERY.CO.UK

188 STAMFORD HILL  
LONDON  
N16 6QX


The Albanian newspaper in London

**THE ALBANIAN**  
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Kush do ta besonte që tre vite pas 18 prillit 2021, kur Edi Rama u ul e Aeroportin e Kukësit bashkë me udhëtarët e ardhur nga Londra, gjithçka do të ngjajë si një pamundësi, qoftë edhe për tu turpëruar.

Kaq shumë zell, kaq shumë impenjim kishte ato ditë, sa që shumëkush besoi se vërtetë qarku më i varfër i vendit, kishte ardhur në një pikë kthese dhe se turizmi, jo vetëm nga

## KUSH I 'NGRIU' FLATRAT E VERIUT?

Londra, do të ishte shpëtimtar për mjerimin e paskajshëm të qarkut.

Gati-gati nostalgjike në kufinj të së pabesueshmes duken ato pamje, ku duket se nuk kishin fund karriget e mbushura me njerëz të administratës, dhe fjalimi i famshëm i kryeministrit se e përmbushi premtimin e tij për të çuar në aeroport çunat e Londrës (mbase ky term u përdor për herë të parë nga kryeministri) e paskërkan sharë kryeministrin me libër shtëpie.

Ngjason me një tragji-komedi ku aktori i vetëm vjen në skemë, me gjithë pathosin e tij, me 'fuqinë e Mujit' i pret lakun e varfërisë qarkut më të varfër të republikës.

Duartrokitje të pafundme.



Lavdi shpëtimtarit!

Lavdi kryeministrit që po e bën Shqipërinë, që u kujtua edhe për këtë qark verior më i varfër i republikës...

Asnjë fjalë nuk u tha për pronarët, menaxhesit e këtij aeroporti pasi do

të binte edhe fabula e shpëtimtarit... por pas kaq vitesh ka vetëm një pyetje; Kush i ngriu "Flatrat e Veriut"? (kështu quhet aeroporti i Kukësit).

Mjafton një kerkim i thjeshtë në internet për të shikuar se numri i fluturimeve në Aeroport është zero. Zhbëhet pël-hura e turpshme që u end ato ditë në prag-fushatën elektorale dhe Flatrat e veriut mbeten të ngrira. Asnjë fluturim i vetëm, asnjë ardhje, asnjë shkuarje duke e lënë aeroportin jo vetëm pa 'çunat e Londrës'

por pas asnjë lloj çuni apo çupe, në bumin e madh të turizmit që ushton në çdo media.

Do të ishte më e natyrshme pyetje se çfarë ndodhi me Aeroportin e Kukësit?

Do të ishte detyrim i kryeministrit të përgjigjej dhe ai qark do të dilte nga agonia e mjerimit, kryeministri që vendosi takesën në rrugën e kombit, u hoqi edhe këtë shans banorëve të qarkut të Kukësit, që aeroportin e kanë të mbyllur, si për të ruajtur të pandryshueshëm mjerimin, bashkë me tragjikomedinë se na ishte njëherë kryeministri që preu një shirit, por aeroporti vazhdon të jetë i mbyllur. (Vetëm për pak kohë ka operuar me ndonjë linjë të papërfillshme). Kushedi sa herë do të kujtohet thënia e Kurtit se dëshiron të vijë në Shqipërinë e Kastriotit dhe jo të Kastratit... ribotim

Discover The Latest Trends in Technology

**Dotech**  
website

“ AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE PËR BIZNESIN TUAJ? ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT




The Albanian

You **Talk**  
We **Listen.**

4.9<sup>/5</sup>



*Because your case isn't just another file — it's your life.*



**Secure  
your right  
to work,  
live and be  
FREE in the  
UK.**



**Meet**

**OLIVERTA MEDIU**

Solicitor, Partner

**+44 (0)20 7063 9040**

Call now to book your confidential consultation!

079 4603 5736

o.mediu@wslegal.co.uk

**Leicester Office:**  
3rd Floor, St. George's House, 6 St George's  
Way, Leicestershire, LE1 1QZ, UK

**Head Office:**  
2nd Floor, 2-5 Minories,  
London EC3N 1BJ

**Immigration Law:**

- Visa applications & appeals (work, student, spouse, etc.)
- Indefinite Leave to Remain (ILR) & British citizenship
- Asylum & human rights claims
- Detention, bail, and deportation defense
- Sponsorship & business immigration

**Family Law:**

- Divorce & separation
- Child custody & visitation rights
- Domestic violence protection orders
- Prenuptial & postnuptial agreements

**Providing expert legal support to all—  
regardless of race, nationality, age, gender, or identity.**



ARBEN MANAJ

Mbyllja e Shërbimit Shëndetësor Kombëtar për Anglinë, dhe jo për pjesët e tjera të Britanisë si Skocinë, Uellsin dhe Irlandën e Veriut, të cilat kanë kompetenca ekskluzive në bazë të decentralizimit, ishte një njoftim i papritur, të cilën kryeministri Stamer e cilëson këtë masë si të nevojshme, edhe pse kjo është krahasuar me shkurtime të ngjashme që po bën Elon Musk në Amerikë në rrodhet e administratës.

Zëdhënësi i qeverisë britanike thotë se Inteligjenca artificiale dhe dixhitalizimi do çlirojnë rreth 45

miliardë sterlina që mund të shpenzohen në sektor të tjerë të shëndetësisë.

Mendohet të shkurtohen rreth 15 mijë e 300 vende pune dhe 3300 zyrtarë në departamentet qeveritare të Shëndetësisë. Në total i gjithë Shërbimi Shëndetësor britanik mendohet se ka të punësuar rreth 1 milionë e 365 mijë vetë dhe ka një buxhet prej më shumë se 190 miliardë e 300 milionë çdo vit.

Ky shërbim shëndetësor është krijuar në 5 korrik të vitit 1948 pas Luftës së Dytë Botërore nga qeveria Laburiste e asaj kohe dhe është sistemi i dytë më i madh në botë i shërbimit shëndetësor pas atij në Brazil.

Kryesisht ky shërbim shëndetësor financohet nga qeveria dhe të ardhurat e taksave dhe një pjesë e vogël nga kontributet që sigurohen nga Sigurimet Kombëtare. Është një shërbim falas në momentin e dhënies së tij për të gjithë bri-



tanikët.

## STARMER MBYLL SHËRBIMIN SHËNDETËSOR! KRYEMINISTRI I ANGLISË BËN SHKURTIME TË NGJASHME SI ELON MUSK NË SHBA

Mbyllja e Shërbimit Shëndetësor Kombëtar për Anglinë, mendohet të zgjas rreth dy vjet për tu përmbyllur, dhe qeveria e justifikon këtë masë si nevojë për të përmbushur premtimin elektoral për shkurtime të listës së pritjeve për pacientët. Opozita e ka mbështetur këtë masë.

Ka pasur edhe në të shkuarën përpjekje nga konservatorët për privatizim të këtij shërbimi, i cili për britanikët është i shenjtë si institucion publik dhe me pasoja elektorale për çdo qeveri, te ditës, nëse tentohet të privatizohet apo dobsohet.

Laburistët thonë se këto reforma janë më të thellat në fushën e kompetencave decentralizuese në historinë e Shërbimit Shëndetësor britanik, i cili vuan realisht nga një burokraci e dukshme menaxhuese, si shume institucione publike, përndryshe nga ato private, edhe pse fondet kurrë nuk kanë munguar në këtë sektor. TCH

**Dotech**  
website

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni  
ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

**MY  
PERFUMERY**

on top of sale, extra  
10% discount for the  
Albanian community

**10%**  
OFF

contact us


*Premium  
Perfume Store*

[www.myperfumery.co.uk](http://www.myperfumery.co.uk)

contact us

020 8800 1035

188 Stamford Hill  
London N16 6QX



[WWW.MYPERFUMERY.CO.UK](http://WWW.MYPERFUMERY.CO.UK)

# ARTAN LLABJANI: TË DREJTOSH ODËN EKONOMIKE KOSOVARO-BRITANIKE

Ai është padyshim një ndër shqiptarët më të suksesshëm në Britaninë e Madhe.

Ishte thjesht një 14-vjeçar kur u gjend në ishullin britanik dhe si shumë shqiptarë të tjerë të Kosovës përjetonte traumat e largimit nga vendlindja që digjej.

Artan Llabjani ishte plot ëndërra dhe se ishte i bindur në vetvete, se asgjë nuk do të ndalonte atë të t'i realizonte. Studimet për drejtësi i kreu me sukses dhe si një ndër studentët më të dalluar u rekomandua që të punësohej në një firmë avokatore në Londër.

Ky mbase ishte edhe fillimi i një udhëtimi domethënës drejt suksesit.

Rezultatet e jashtëzakonshme që ai pati në firmë, ku ndihma sidomos për bashkëatdhetarët, bënë që ai të kërkohej edhe prej fimave të tjera.

Padyshim që Artan Llabjani është modeli i shqiptarit të suksesshëm, mbase i pari shqiptar që u bë Partner (bashkëpronar) në një ndër firmat avokatore më të suksesshme në Londër.

Ai është shquar për kontributin e tij në ndihmën profesionale të ambasadave shqiptare (Shqipërisë dhe Kosovës) në Londër, shoqatave të komunitetit etj.

Kjo nuk ishte plotpërbushëse për Artanin i cili prej vitesh ndërmori hapin për themelimin e Odës Ekonomike Kosovaro-Britanike. Në intervistën e mëposhtme ai na njuh me këtë iniciativë dhe planet për të ardhmen.

**Kur dhe pse është themeluar Oda ekonomike Kosovaro - Britanike?**

Oda Ekonomike Kosovaro-Britanike është një organizatë jo-fitimprurëse e themeluar më 13 dhjetor 2021. Qëllimi i saj kryesor është të nxisë lidhje të forta biznesi midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Republikës së Kosovës dhe të ndihmojë në ndërtimin e lidhjeve biznesore.

**Cili është misioni i saj?**

Misioni i Odës është të forcojë lidhjet biznesore midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës, duke promovuar mundësi dhe partneritete për përfitime të ndërsjella.



Oda vazhdoi me një lansim në Prishtinë më 15 shkurt 2022.

Ky eveniment e konsolidoi më tej angazhimin e Odës për të përmirësuar lidhjet biznesore dhe për të ofruar mundësi të reja për bashkëpunim midis Kosovës dhe Britanisë.

Që nga këto lansime të rëndësishme, Oda poashtu ka organizuar një sërë eventimesh të rëndësishme. Një nga ngjarjet më të shënuara ishte Përkujtimi i Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë më 28 tetor 2023, i mbajtur në Dhomën e Lordëve (House of Lords).

Ky aktivitet kremtoi Ditën e Pavarësisë të Shqipërisë dhe ofroi një platformë për lidhjen e palëve

partnerë dhe mysafirë të shquar për të festuar sukseset biznesore dhe për të forcuar më tej marrëdhëniet midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës. Oda Ekonomike Kosovaro-Britanike gjithashtu organizoi një aktivitet për Ditën Ndërkombëtare të Gruas më 27 mars 2023, me ish-Presidenten Atifete Jahjaga.

Ky aktivitet theksoi rëndësinë e barazisë gjinore dhe rolit të grave në biznes, duke forcuar angazhimin e Odës për diversitet dhe përfshirje.

Po ashtu, më 2 dhjetor 2022, Oda organizoi aktivitetin Klima e Investimeve në Mbretërinë e Bashkuar, duke ofruar informacione të rëndësishme për mundësitë e investimeve në Mbretërinë e Bashkuar dhe mundësi të vlefshme për bizneset që dëshirojnë të angazhohen me këtë treg.

Për të festuar misionin e saj, më 14 maj 2022 u mbajt Gala e Dhomës së Tregtisë Kosovaro-Britanike, një aktivitet që promovoi investimet dhe festoi arritjet e anëtarëve dhe partnerëve të Odës, duke forcuar lidhjet mes Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës.

**Cilat janë planet për të ardhmen?**

Fokusimi është në zgjerimin e anëtarësisë dhe mundësive për rrjetëzim për të ndihmuar në ndërtimin e marrëdhënieve biznesore midis Kosovës dhe Mbretërisë së Bashkuar, duke ofruar mundësi investimesh që do të përfitojnë ekonominë e të dyja vendeve.

Oda synon të forcojë lidhjet midis dy shteteve dhe të krijojë një platformë të qëndrueshme për bashkëpunim në sektorë të ndryshëm.

**Mesazhi për shqiptarët e Britanisë**

Oda inkurajon komunitetin shqiptarë në Mbretërinë e Bashkuar të angazhohen në aktivitetet e saj dhe të shfrytëzojnë mundësitë e biznesit që ofrohen përmes rrjetit të Odës.

Ftojme të gjitha bizneset nga Kosova, Shqipëria dhe Mbretëria e Bashkuar të na kontaktojnë dhe të eksplorojnë mundësitë e bashkëpunimit.

Ekipi ynë i ekspertëve dhe rrjeti ynë i gjerë i lidhjeve do t'i ndihmojë ata të ndërtojnë marrëdhënie në sektorë të ndryshëm dhe të arrijnë rritje dhe sukses të ndërsjellë.



**Cilat janë aktivitetet kryesore që keni organizuar?**

Udhëtimi i Odës filloi me lansimin e saj zyrtar në Parlamentin e Britanisë më 13 dhjetor 2021, duke shënuar fil-

limin e misionit të saj për të mbështetur dhe forcuar marrëdhëniet biznesore midis Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës.

Pas suksesit të lansimit në Britani,

të interesuara, duke forcuar lidhjet midis Mbretërisë së Bashkuar dhe komuniteteve shqiptare/kosovare.

Më 25 nëntor 2023, Oda organizoi Galën 2023, duke mbledhur anëtarë,

# ZYBER

**Your one-stop destination for all needs.**

**Smashing prices**

**Super çmime, për më shumë visitoni dyqanet tona!**

Paint mixing in stores 10,000 colours available.

<p>Dulux Trade Supermatt White 10L</p>  <p>£33.32 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Vinyl Matt Pure Brilliant White 7.5L</p>  <p>£25.81 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Vinyl Matt White 10L</p>  <p>£41.65 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Diamond Matt Pure Brilliant White 10L</p>  <p>£72.48 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Contract Matt Brilliant White 10L</p>  <p>£18.50 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Trade Vinyl Matt Emulsion Brilliant White 10L</p>  <p>£29.98 Ex. VAT</p>
<p>Leyland Trade Super Leytex Matt Brilliant White 15L</p>  <p>£22.48 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Trade Acrylic Eggshell Brilliant White 5L</p>  <p>£30.81 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Jonmat Premium Contract Matt Brilliant White 10 L</p>  <p>£23.75 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Covaplus Vinyl Matt Brilliant White 10L</p>  <p>£29.98 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Covaplus Vinyl Matt Brilliant White 5L</p>  <p>£21.65 Ex. VAT</p>	<p>Johnstones Trade Acrylic Eggshell Brilliant White 5L</p>  <p>£38.31 Ex. VAT</p>
<p>Crown Vinyl Matt White 7.5L</p>  <p>£19.98 Ex. VAT</p>	<p>Crown Trade Clean Extreme Matt White 5L</p>  <p>£29.98 Ex. VAT</p>	<p>Crown Trade Quick Dry Fastflow Satin White 5L</p>  <p>£29.15 Ex. VAT</p>	<p>Macpherson Eclipse Emulsion Brilliant White 15L</p>  <p>£21.65 Ex. VAT</p>	<p>Macpherson Eclipse Matt 15L Magnolia</p>  <p>£21.65 Ex. VAT</p>	<p>Macpherson Durable Acrylic Matt Brilliant White 5L</p>  <p>£22.48 Ex. VAT</p>
<p>Macpherson Vinyl Matt Paint Brilliant White 10 L</p>  <p>£20.98 Ex. VAT</p>	<p>Armstead Trade Contract Matt White 10L</p>  <p>£20.81 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Quick Dry Gloss Pure Brilliant White 5L</p>  <p>£44.15 Ex. VAT</p>	<p>Dulux Trade Diamond Matt Pure Brilliant White 5L</p>  <p>£34.98 Ex. VAT</p>	<p>Leyland Acrylic Primer Undercoat White 5L</p>  <p>£24.50 Ex. VAT</p>	<p>Crown Trade Fastflow Quick Dry Gloss White 5L</p>  <p>£28.31 Ex. VAT</p>
<p>Dulux Trade Quick Dry Wood Primer Undercoat 5L</p>  <p>£55.81 Ex. VAT</p>	<p>Zinsser BIN Aqua 2.5L</p>  <p>£49.98 Ex. VAT</p>	<p>Gyproc Easifill 60 Filler &amp; Jointing Compound 10Kg</p>  <p>£19.98 Ex. VAT</p>	<p>Ronseal High Performance Wood Filler, White, 3.7 kg</p>  <p>£33.31 Ex. VAT</p>	<p>Uniwipe x6 Ultra Grime Ultragrim Industrial Multi-Purpose Cleaning Wipes X100</p>  <p>£49.89 Ex. VAT</p>	<p>Uniwipe X6 Ultragrim Textured Power Scrub Surface Cleaning Hand Wipes X80 Pack</p>  <p>£59.98 Ex. VAT</p>

## WHY US?

✓ Expert service

✓ Delivery In UK

✓ Open 7 days a week

## FIND US

1342 Greenford Road, Greenford, UB6 0HL

0207 387 5328

168 Kentish Town Rd, Camden Town, NW5 2AG

0207 482 2722

76 Elmers End Road, Beckenham, SE20 7UX

0208 778 4222

49-51 Fulham High Street SW6 3JJ

0207 736 8153

73 Chase Side Southgate London N14 5BU

0208 882 2490

57 Wembley Hill Road, London, HA9 8BE

0204 537 4791

52 Northcote Rd, Clapham, London SW11 1PA

0203 093 1646

Unit 6 Grand Union Trade Park Abbey Road, London, NW10 7UL

[www.zyberltd.co.uk](http://www.zyberltd.co.uk)

ZYBER LTD

zyberltd

zyber.ltd

Zyber Ltd

zyber.ltd

## SHAIP KAMBERI

Filozofia e UDBË-s ndaj shqiptarëve dominuese në fjalorin e politikanëve serb.

Konflikti serbo-serb po thellohet.

Por, as kjo armiqësi mes tre taborëve të krijuara në Serbi, me valën e protestave studentore - pushteti, studentët dhe opozita - nuk kalon pa përmendur "armiqtë e përjetshëm, shqiptarët".

Gjuha e urrejtjes ndaj shqiptarëve për dekada me radhë në Serbi është shndërruar në kulturë politike, sjellje të përditshme të zyrtarëve më të lartë. Sa më antishqiptarë aq më serbomadh. Kjo është logjika dominante ndër vite.

Kësaj radhe, kryetari i njëjës parti politike DS, Srgjan Milivojeviq, paska dalë me akuza se gjatë protestës së 15 marsit në Beograd, në "Parkun e pionerëve" ka pasë narkotrafikantë nga Tërnoci".

Sipas tij, ata kanë qenë në shërbim të "pushtetit të Vuçiqit me dyrë të sulmohjës studentët".

Nuk mjafton ta quash një serb tradhëtarë, të korruptuar, kriminel e jonjeri. Jo akuza nuk është e plotë nëse ai edhe nuk etiketohet se "është" bashkëpunëtorë i shqiptarëve.

Nga ky diskurs antishqiptar dhe kjo gjuhë kriminalizuese nuk është liruar as pozita as opozita në Serbi.

Ministra të regjimit të Vuçiqit dhe vetë kryeparlamentarja hapur, pa ngurri, përdorin termin fyes "shiptari".

Por është aq më keq kur akuza të këtilla të pabaza vijnë nga kreu i një partie që veten e

cilëson si "proevropiane".

flasë për krimet e luftës, gjenocidin,

# NARKODILERËT I PRODHON "JOVANJICA" JO TËRNOCI



Ky kriminalizim i Tërnocit është prodhim i moçëm i shërbimit të UDBË-s, e cila ndër vite me këtë teori të kriminalizimit ka tentuar të arsyetojë diskriminimin shtetërorë ndaj shqiptarëve dhe të diskreditojë kërkesat legjitime politike.

Është fakt i pakontestueshëm se Serbia po vuan jo vetëm nga regjimi i Aleksandar Vuçiqit, ajo po vuan nga një opozitë e pa organizuar e pa ide, rusofile e albanofobe.

Një opozitë e cila me keqorganizim, me mungesë të një vizioni për një Serbi tjetër, pa aftësi e pa guxim që hapur të

varrezat masive në Batajnicë dhe gatishmërinë të hjekë dorë nga ambicet hegjemoniste serbomadha po ja mundëson Aleksandar Vuçiqit që në mënyrë komode të sundojë për 13 vjet.

Në gjithë këtë shtrohen pyetjet:

A pak ka narkodilerë në Beograd që Vuçiqi të kërkojë mercenarë në Tërnoc?

Nëse një parti si DS, e nga e cila pritej që të jetë avangardë e një Serbie tolerante e evropiane, çfarë mbetet të presim nga partitë që hapur janë kundër BE-së, e janë putinofile?

Fundja, labororet dhe plantazhet e droges, sikurse "Jovanjica" janë gjetur nëpër Serbi e jo në Tërnoc.

## AUGUSTIN PALOKAJ

Edhe pse kanë kaluar 26 vjet, akoma përvjetori i nisjes së sulmeve ajrore të NATO-s nxit shumë kujtime. Për shqiptarët e Kosovës janë kujtime të përziera. Ata e kujtojnë si nisjen e fundit të terrorit serb mbi ta, por edhe si periudhën e përshkallëzimit të krimeve serbe në terren. Në anën tjetër, në Serbi, edhe pas 26 vjetësh nuk shihet aspak gatishmëri për të pranuar se përse ndërhyri NATO-ja.

Përpjekja e vazhdueshme e Serbisë, pa marrë parasysh se kush është në pushtet, për ta paraqitur ndërhyrjen e NATO-s si një agresion të panevojshëm, është pjesë e mungesës së vullnetit për ta tejkaluar trashëgiminë nga e kaluara. Serbia në këtë drejtim llogarit edhe në harresën e bashkësisë ndërkombëtare dhe në faktin se gjeneratat e reja në botë nuk e dinë se si dhe përse ndodhi kjo ndërhyrje.

Prandaj Beogradi e paraqet veten si viktimë të "agresionit", ndërsa me asnjë fjalë nuk i përmend arsyet që sollën deri te kjo ndërhyrje. Nuk vendosi NATO-ja kot e pa asnjë arsye t'i sulmonte forcat e Milosheviçit. Ndërhyrja e NATO-s ishte rezultat i dështimit të proceseve të stërzgjatura për të gjetur një politikë jo vetëm në rastin e Kosovës, por më herët edhe në atë në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë.

Ishte një gabim i vazhdueshëm politik në atë kohë i bashkësisë ndërkombëtare, që kërkonte për gati dhjetë vjet zgjidhje politike me Milosheviçin, duke llogaritur se diktatori serb ishte bashkëbisedues i duhur. Rezultati ishte katastrofik. Kroacisë, pas shumë dëmeve dhe viktimave, iu desh ta

çlironte vetë tokën e saj të okupuar.

Çmimi i agresionit serb në Kroaci vazhdon të ndihet edhe sot, me fusha të minuara që nuk janë pastruar ende dhe me rreth 1.600 të zhdukur, fati i të cilëve nuk është zbardhur. Marrëveshja paqësore për Bosnjë-Hercegovinën, e arritur në Dayton e me të cilën iu dha fund luftës, e copëtoi këtë shtet dhe i shpërbleu ata që bënë gjenocid me formimin e Republikës Sërpska, duke ua dhënë serbëve pothuajse gjysmën e shtetit me të drejtën që të mbajnë peng çdo hap në atë shtet.

Pasojat shihen edhe sot, ku nga entiteti serb vinë thirrje për shpërbërje të Bosnjë-Hercegovinës si shtet, ndërsa shteti është jofunksional. Ndërsa në rastin e Kosovës u hezitua aq shumë me nisjen e ndërhyrjes ndërkombëtare dhe iu dha hapësirë ushtarëve e paramilitarëve të Serbisë që t'i vazhdojnë pa pasojë krimet e tyre ndaj shqiptarëve. Para 26 vjetësh, pasi nga Beogradi ishte kthyer duarthatë ish-i dërguari i posaçëm amerikan, Richard Holbrook, dhe i kishte thënë sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, se diktatori Slobodan Milosheviç kishte refuzuar edhe kërkesën e fundit për t'i dhënë fund fushatës së pastrimit etnik të shqiptarëve në Kosovë, NATO-ja e dha urdhrin aktivizues dhe nisën sulmet ajrore të kësaj aleance.

Me ndërhyrjen në Kosovë, NATO-ja e mbajti premtimin ndaj popullatës

# NUK DUHET HARRUAR PSE U DESH NDËRHJRJA E NATO-S



shqiptare dhe ndaj atyre liderëve që kishin pranuar kompromisin e Rambouilletit. Mbajti edhe fjalën kërcënuese dhënë Milosheviçit se nëse nuk e pranon atë marrëveshje, nëse nuk dëshmon gatishmëri për ta ndalur dhunën ndaj shqiptarëve dhe tërheqjen e forcave serbe, do të pasojë ndërhyrja ushtarake. NATO-ja përballë me humbjen e madhe të kredibilitetit të saj, ndërsa Milosheviç sikur nuk besonte se do të vinte deri te ndërhyrja. Në një mënyrë, NATO-ja me këtë ndërhyrje deshi edhe t'i përmirësonte gabimet që i kishte bërë duke hezituar aq gjatë që të ndërhynte. Nuk i ka bërë NATO-ja krimet në Prekaz, Reçak, Izbicë, Padalishtë dhe Krushë. Nuk i ka futur NATO-ja nëpër frigo trupat e shqiptarëve të vrarë për t'i dërguar në Serbi dhe për t'i varrosur nëpër varreza ma-

sive atje, në përpjekje për të fshehur gjurmët e krimeve. Këto krime nuk mund të harrohen dhe nuk guxojnë të harrohen.

Serbët, sa herë që dëgjojnë arsye dhe teori konspirative për ndërhyrjen e NATO-s, nga "trëthanat e pafavorshme ndërkombëtare" e deri te "dëshira për të mbuluar skandalin e Bill Clintonit me Monica Levinski", le të ndalen pak dhe të mendojnë për mijëra viktimat civile shqiptare që u vranë në prag të shtëpisë, për mbi një milion të dëbuar nga shtëpitë e tyre, qindra apo mijëra viktimat të bartura në Serbi dhe të riarrosur në varreza masive nëpër Serbi. Ndërhyrja e NATO-s ishte për t'u dhënë fund këtyre krimeve e jo për të dënuar dikë. Dhe po ashtu, ishte ndërhyrje për të mos e lejuar përsëritjen e gjenocidit të

përmasave të Srebrenicës, ku para 30 vjetësh u masakruan mbi 8.000 meshkuj boshnjakë për vetëm disa ditë.

Do të ishte ideale sikur të mos kishte pasur nevojë për ndërhyrjen e NATO-s. Por ishte Serbia, ajo që nuk la asnjë mundësi tjetër. Dhe, ndonëse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si vendi kryesor i NATO-s, ishin në krye të këtij operacioni për ndërhyrjen e NATO-s, për të u pajtuan të gjitha vendet anëtare dhe në to morën pjesë edhe vendet evropiane. Në atë kohë kishte mbështetje të fuqishme edhe të popullatës evropiane për atë ndërhyrje, sepse ishin të vetëdijshëm se agresionit të tillë dhe krimeve të Serbisë duhej dhënë fund në një mënyrë

## BRITANI E MADHE NUMËR REKORD EMIGRANTËSH KALOJNË KANALIN LA MANSH

Numri i migrantëve që mbërrin në Britaninë e Madhe pasi kaluan La Manshin ka vendosur një rekord të ri për tre muajt e parë të vitit.

“Ka pasur 5 847 mbërritje deri më tani në 2025, duke përfshirë 335 të dielën”, sipas shifrave të përkohshme të Home Office.

Kjo është tashmë më e lartë se 5 435 emigrantë që mbërritën përgjatë janarit, shkurtit dhe marsit të vitit 2024 – në atë kohë, një rekord për tremujorin e parë të një viti kalendarik.

Është gjithashtu shumë mbi 3 793 ardhjet në tre muajt e parë të 2023 dhe 4 548 në periudhën ekuivalente në 2022.

“Totali kumulativ për vitin 2025 prej 5 847 personash është rritur 36% në këtë pikë vitin e kaluar (4 306) dhe 59% më i lartë se në këtë fazë në 2023 (3 683)”, sipas analizës së agjencisë së lajmeve PA.

Shifrat vijnë pasi qeveria është zotuar të godasë kontrabandën e njerëzve me plane për të futur vepra të reja penale dhe për t'i dhënë policisë dhe agjencive të zbatimit kompetenca të stilit të terrorit për të frenuar kalimet.

Javën e kaluar, roja bregdetare franceze konfirmoi se dy migrantë



vdiqën në dy ditë duke u përpjekur të kalonin La Manshin të mërkurën dhe të enjten.

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin ka raportuar disa vdekje të tjera të emigrantëve, të cilat besohet se janë të lidhura me përpjekjet për të udhëtuar nga Evropa kontinentale në MB këtë vit.

Një zëdhënës i Home Office tha se “ne të gjithë duam t'i japim fund kalimeve të rrezikshme me varka të vogla, të cilat kërcënojnë jetët dhe minojnë sigurinë tonë kufitare. Bandave

të kontrabandës së njerëzve nuk u intereson nëse njerëzit që shfrytëzojnë jetojnë apo vdesin, përderisa paguajnë. “Ne nuk do të ndalemi në asgjë për të çmontuar modelin e tyre të biznesit dhe për t'i sjellë ata para drejtësisë”.

***Futën ilegalisht me kamion në Britani një grua dhe një fëmijë 6-vjeç, pranga shoferit dhe dy shqiptarëve***

Tre persona, mes tyre dy shqiptarë, janë arrestuar pasi futën një grua dhe një fëmijë 6-vjeçar ilegalisht në Britaninë e Madhe me anë të një kamioni.

Sipas komunikatës për media të Agjencisë Kombëtare të Krimin (NCA), treshja u arrestua nga oficerët e agjencisë mëngjesin e 23 marsit, pasi kamioni mbërriti me një traget nga Hook of Holland në portin e Killingholme në North Lincolnshire, sipas mediave të huaja.

Ai u kontrollua nga Forcat Kufitare,

të cilët po punonin me NCA-në. Gruaja dhe fëmija, të dy shtetas shqiptarë, u gjetën të fshehur në kabinën e kamionit dhe iu dorëzuan autoriteteve të emigracionit.

Shoferi i kamionit, një 36-vjeçar nga Polonia, u arrestua. Ai u akuzua për bashkëpunim në emigracion të paligjshëm dhe pritet të dalë sot para Gjykatës Magjistrale të Grimsby-t.

Menjëherë pas kësaj, dy shqiptarë të moshës 44 dhe 26 vjeç u arrestuan gjithashtu nga oficerët e NCA-së pak milje larg portit ku u ndalua kamioni. Ata ishin nisur me makinë nga zona Hendon e Londrës dhe dyshohej se po shkonin për tek kamioni në të cilin u gjetën gruaja dhe fëmija 6-vjeçar.

44-vjeçari u lirua me kusht në pritje të hetimeve të mëtejshme, ndërsa 26-vjeçari mbetet në paraburgim pasi besohet se është subjekt i një Njoftimi të Kuq të Interpolit, si pasojë e të cilit ai mund të ekstradohet në Itali, ku dhe kërkohet në lidhje me veprat penale të trafikut të drogës.

“Neutralizimi i kimit të organizuar të imigracionit mbetet një prioritet kryesor për NCA.

Shumë nga grupet e përfshira janë të vendosura jashtë shtetit, ku ka individë me bazë në Mbretërinë e Bashkuar të përfshirë në këtë lloj kriminaliteti iu them se do kenë vëmendjen e plotë të NCA dhe partnerëve tanë. Hetimi ynë për këtë incident po vazhdon”, tha Jacque Beer, Shefi Rajonal i Hetimeve të NCA.

**Free**  
contact  
lens trial

With help and support  
whenever you need it

Book an appointment at [specsavers.co.uk](https://www.specsavers.co.uk)

You're better off with

**Specsavers**

## ERMAL MULOSMANI

**Kandidaturat ai nuk i shpall, mundësisht deri një ditë përpara afatit. Le të shpërthejnë servilizmat, lëpirjet, fantazitë, miqësitë, thashethemet, gazetatat, analistët!**

Sot jam befasuar fort me bërjen publike të një "përplasjeje" mes Kryeministrit dhe Erion Veliajt. Kurrë nuk e kam besuar se një gjurmë e tillë dinjiteti do të gjendej në personalitetin e Veliajt.

Dhe intuita nuk do më zhgënjente, befasia ishte vetëm një iluzion.

Gjatë këtyre ditëve e kam kursyer Veliajn si një njeri karriera politike e të cilit ka marrë fund dhe burgu do të jetë adresa e tij për një kohë të gjatë. Nuk e kam qejf të jem pjesë e korit që ngazellen për fatkeqësitë e tjetrit.

Por ky statusi i fundit i tij, i neveritshëm, e meriton t'ia publikoj edhe një herë shkrimin më të saktë që kam bërë ndonjëherë për raportet e Ramës me Veliajn.

\*\*\*\*

Unë e njoh Erion Veliajn," – fillonte spoti promovues i Kryeministrit Rama në fushatën e zgjedhjeve bashkiake të 2015-ës në Tiranë. Vazhdimi ishte i gjatë, por Rama i kishte thënë të gjitha me këtë fjalë të shkurtër.

"Unë e njoh Uriah Hipin," – më tingëllonte mua në veshë. I kam të qarta të gjitha arsyet se pse Uriahu fitoi ndaj kandidatave alternative për postin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Nëse mendoni se fitoi për ndonjë arsye normale, si zelli për punë, idetë novatore a gjepura të tilla, kjo do të thotë se nuk e keni idenë se kë keni kryeministër.

Ai në fjalime vërtet thotë "T'i gjejmë punës njeriun dhe jo punën njeriut", por kjo vlen veç për fjalime. Ndërsa

## ZEUSI DHE URIAHU I KATUNDIT TONË



në realitet Kryeministri argëtohet shumë nga konkurenca mes sivëllezërve të sojit, në përpjekjet servile për vëmendjen e Tij.

Kandidaturat ai nuk i shpall, mundësisht deri një ditë përpara afatit. Le të shpërthejnë servilizmat, lëpirjet, fantazitë, miqësitë, thashethemet, gazetatat, analistët!

Zeusi i kundron nga lart, me nënqeshje dhe me ndjesinë e Perëndisë, që "vran e kthjell" mbi këtë katund, dhe shikon sesi katundarët bëjnë parashikimet e motit.

I la edhe atëherë kandidaturat të shpërthenin. I pari ishte Artan Lame, një bashkëpunëtor i vjetër i Zeusit të katundit tonë. Lameziu, që vdes për monumente të vjetra, pulla poste, togëza këmishash e rripash të kapterëve të Zogut e gjëra të tilla, kishte 2 vjet që merrej me legalizimet. Domethënë, njeriut që për ideal të shpirtit ka mbrojtjen e monumenteve të kulturës, personit që kishte 4 vjet që bërtiste për ndërtimet kaotike, bathorizimin e Tiranës, rregullin urban, pikërisht atij i la hiç më pak sesa detyrën "t'u jepte tapinë këtyre të Bathores".

Kokëulur, martiri Lame nisi punën

nëpër getot që shante, dhe u çonte tapinë te shtëpia ndërtuesve të paligjshëm, të cilët kishin grabitur tokën e pronarëve. Lameziu, që tallej me "Tokën e Xanun", Zeusi e çoi në negociatën me Nue Rrokun. Dhe Nua Rroku, sipas gojëve të liga, nuk e la pa shpërblyer Lameziu me mirënjohje për begenisjen.

Pas dy vitesh mirëqenieje me Nuan, Lameziu deklaroi: "Më hanë duart për Tiranën!", dhe u vetëshpall kandidat 6 muaj përpara. E mbani mend si e kundërshtoi Zeusi kandidaturën? Kur dikush e pyeti, ai u përgjigj "Pikërisht se i hanë duart, ne nuk do ta kandidojmë!" Publikisht, në televizor, ia dha shuplakën. Pas një viti Lamja kaloi në infarkt dhe mezi shpëtoi. Zoti qoftë me të në të ardhmen e inshalla nuk ka qenë deklarata e Zeusit që e bëri me zemër.

Uriahu dukej në rrugë të mbarë. Lamja iku, rruga po shtrohej. Zeusi nuk jepte shenja, por Atij i pëlqen gjendja e pezullt, ndaj kjo nuk është ndonjë shenjë e keqe.

Pastaj doli ai spoti "Unë e njoh Uriahun".

Pikërisht ngaqë e njihte servilizmin ekstrem, lëpirjen, nënshtrimin, im-

itim deri në detaje të shefit, Ai vendosi për Uriahun. Por vetëm këto nuk mjaftonin. Zeusi ia njihte edhe aftësinë për intriga, helm, poshtërsi. Ai e dinte po kaq mirë se të gjitha këto intriga do të zhvilloheshin paralelisht me servilosjen e nënshtrimin dhe do t'i drejtoheshin vetëm atij, Zeusit të katundit tonë! Kjo gjë i pëlqente pa masë dhe kjo ishte arsyeja pse e kandidoi.

Uriahu pa t'i rritej ndikimi në katund. Ndonjë iluzion, që ia ushqenin katundarët tanë, se "tanimë ka ardhur koha jote", i pëlqente. Jargë i dilnin nga goja, dopamina i rritej në tru. Megjithatë ai kurrë nuk mund të ishte i sigurtë, ndaj priste si Beria agoninë e Stalinit. Ditën përpiquej të imitonte deri edhe nënshkrimin, lëre pastaj fjalorin dhe gjestikulacionin.

Ndonjëherë fantazia e orëve të mëngjesit pa gjumë e çonte shumë larg, në një kohë pa Zeusin e katundit tonë. Pastaj në çast trembej se mos sinjale të veprimtarisë subversive të trurit të tij mbërrinin deri në Surrel dhe kapeshin nga antenat e Zeusit. I largonte ato mendime dhe e gjente veten fajtor pse mendja e tij nuk i bindet Zeusit si gjithë pjesa e qenies tjetër servile.

Dhe vërtet, dukej se ndonjë sinjal i tillë kishte mbërritur në Surrel. Natën e Vitit të Ri, Zeusi i katundit tonë doli në televizor e tha: "Ka një komplot dhe koka e tij është Uriah Hipi. Ai një ditë do të varet në një nga ato pemët që mbjell vetë në televizor!"

Duheshin edhe 5-6 orë të fillonte festa e Vitit të Ri. Uriahu u tmerrua. Zeusi ia kishte lexuar ëndrrën.

Oh, çfarë drame! E kishte me veten dhe me mendjen që nuk i bindej e shkonte sa andej këndeje!

Ai Vit i Ri u kthye në një mynxyrë. Përpiquej ta detyronte trurin të men-

donte vetëm gjëra të mira për Zeusin, me shpresën se

Ai do t'ia kapte mendimet. U zotua se kurrë nuk do të mendonte më ashtu!

Mendonte si e si të gjente një mekanizëm që i tregon momentin se kur duhet të fillojë të mendojë kundër Zeusit dhe Ai të mos e pikasë. Iu kthye në një makth të madh. Dikur e gjeti një zgjidhje, duhet të gjej rezonimin me mendjen e Zeusit.

Mendja e Uriahut do të ishte e zënë vetëm me përpjekjen për të thënë ato që ai mendonte se po mendonte Zeusi. Pra, të thonte ato gjëra për të cilat ishte i sigurt se i pëlqenin Zeusit, të rriste nivelin e servilizmit dhe nënshtrimin në një shkallë të paparë deri tani.

Me shpresën se duke menduar kaq gjatë për gjëra të mira truri i tij do të zihet dhe nuk do të kishte kohë të shkonte në hone të rrezikshme për qenien e tij. Po sikur mendja të kishte ndonjë çast të lirë?!

Në një emision televiziv kuptoi që meditimi është gjendje pamendimi. Kjo ishte gjeniale! Fytyra iu ndriçua menjëherë! Duhet filluar një kurs meditimi. Sa herë mendja mund të fluturonte, pa dëshirën e tij, në zona të rrezikshme, ky mund ta zaptonte me meditimin. Kjo ishte gjetje e mrekullueshme!

Një ditë, një mik i Zeusit i tregoi atë barcaletën e akrepit që pickoi bretkosën, ndërkohë që kjo po e shpëronte. Për forcë zakoni, Uriahu u tmerrua. Se mos e kishte me atë, me qitje të largët?!

Pastaj u kthjellua. "Unë jam kërmill, jo akrep," — mendoi dhe u qetësua.

13 Prill 2019. U publikua me titullin "Zeusi dhe Uriahu i katundit tonë".

Ish-komandanti suprem i forcave aleate të NATO-së për Evropë, gjenerali Wesley Clark, ka thënë se Serbia duhet ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe se bashkëpunimi ekonomik në mes të dy vendeve do të jetë i pashmangshëm.

Në një diskutim virtual të zhvilluar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, në shënim të 26-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, Clark ka folur për përmirësimin e klimës së biznesit dhe ka inkurajuar Kosovën që të përqafojë bashkëpunimin rajonal me fqinjët si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, madje edhe Serbia.

"Përfundimisht, Serbia do të duhet të

## GJENERALI WESLEY CLARK: PËRFUNDIMISHT, SERBIA DO DUHET TA PRANOJË PAVARËSINË E KOSOVËS

pranojë pavarësinë tuaj dhe bashkëpunimi ekonomik do të jetë i pashmangshëm", ka thënë Clark.

Ai ka theksuar se Kosova ka një pozicion shumë të rëndësishëm strategjik.

"Bota po e shikon Kosovën dhe mënyra më e mirë për të forcuar sigurinë e saj është përmes zhvillimit ekonomik dhe investimeve, veçanërisht nga Shtetet e Bashkuara", citohet të ketë thënë Clark.



Ai në një bashkëbisedimin me drejtorin ekzekutiv të Odës Amerikane, Arian Zeka, a folur edhe për rëndës-

inë e sundimit të ligjit duke kërkuar që Kosova ta forcojë atë dhe ta përdorë atë për të ndërtuar besimin e investitorëve.

Clark ka bërë thirrje për investime në infrastrukturë dhe energji, duke vënë në dukje rezervat e bollshme të linjtit të Kosovës, si dhe ka avokuar për transformimin digjital të vendit, përmirësimin e sistemeve tatimore, lidhjen në brez dhe gjerë të internetit dhe sigurinë kibernetike për të luftuar dezinformimin dhe përmbyshjen e jashtme.

Ai u ka bërë thirrje liderëve të Kosovës që të ndjekin qeverisjen e pastër, unitetin politik dhe të mbajnë një baraspeshë të fortë ndërmjet qeverisë dhe sektorit privat. "Vetëm qeveritë nuk mund të nxisin rritjen – ju nevojitet sektori privat, veçanërisht në teknologjinë e informacionit dhe shërbime, ku talenti dhe aftësitë gjuhësore të Kosovës mund të shkëlqejnë", ka theksuar Clark.

Ai ka folur edhe për rëndësinë e kthimit të të rinjve në Kosovë, për të kontribuar me idetë e tyre për zhvillimin dhe të ardhmen e Kosovës.

# FOR SALE



Klinikë për shitje  
ose me qera në  
Chelmsford Essex  
-3 dhoma shërbimi  
-Reception  
& waiting area  
-Toilets & utility room  
-Në një ndër zonat  
më të frekuentuara  
-E hapur prej vitesh  
dhe me klientelë të  
garantuar

**GJITHASHTU KEMI  
AMBJENTE ZYRASH ME  
QERA**

Për më shumë info  
na kontaktoni tel:  
**07909620140**



24 mars 1999.

# 78 DITË BOMBARDIME: DETAJET KRYESORE TË FUSHATËS SË NATO-S

Pak pas orës 19:00 në kryeqytetin e Serbisë, Beograd, dëgjohej sirenat e para.

Ato paralajmërojnë fluturimin e aeroplanëve ushtarakë të NATO-s mbi qellin e Serbisë.

Pak para orës 21:00, dëgjohej një shpërthim i fuqishëm në fabrikën e aeroplanëve "Lola Utva", në Pançevë të Serbisë.

Flaka dhe tymi mbulon këtë lokacion në periferi të Beogradit. Ky moment shënon fillimin e një fushate 78-ditore të bombardimit të Jugosllavisë.

Aeroplanë të NATO-s bombarduan në territorin e Serbisë, Kosovës dhe Malit të Zi.

Si erdhi deri te bombardimi?

Mes dilemash dhe kundërshtimesh nga Kina dhe Rusia, atëbotë sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, më 23 mars 1999, në orën 22:17, urdhëroi një sulm ajror mbi Republikën Federale të Jugosllavisë.

Arsyetimi, në Serbi nuk ka gatishmëri për zgjidhje politike të krizës së Kosovës.

Sulmet ajrore nisën pa aprovimin e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Vendimi për bombardim u ndërmor pas refuzimit të asokohe presidentit të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq, që të zgjidhej politikisht kriza e Kosovës.

Fakte të rëndësishme

Më 1999, në Kosovë llogaritej se ishin rreth 40 mijë trupa ushtarake jugosllave.

Në mars 1999, UNHCR-ja përlogariste rreth 475 mijë kosovarë të zhvendosur pas ofensivës së forcave ushtarake dhe policore serbe.

Ky numër vazhdoi të rritej dhe deri në fund të luftës, rreth një milion kosovarë ishin larguar nga vendi.

Sipas të dhënave të publikuara nga Fondi për të Drejtën Humanitare, gjatë luftës në Kosovë, më 1998-1999, janë vrarë mbi 13.500 persona – 76 për qind e të cilëve besohet se kanë qenë civilë. Për më shumë se 1.600 persona të zhdukur në luftë vazhdon kërkimi.

## Cka bombardoi NATO-ja?

Bombardimet kishin tri objektiva kryesore: mbrojtjen ajrore jugosllave, sistemet e komandës dhe kontrollit dhe forcat ushtarake serbe të dislokuara në Kosovë.

Sulmet kryesore



24 mars

Bombardohet fabrika për prodhimin dhe riparimin e aeroplanëve në Pançevë, si dhe bombardohen objekte të tjera me rëndësi ushtarake në Serbi.

25 mars

Bombardohet një lokacion në Rozhajë të Malit të Zi, shumë pranë kufirit me Kosovën.

26 mars

Shkatërrohet depoja e karburantit në Lipovicë të Serbisë. Dëmtohet një pjesë e rrjetit elektrik në Batajnicë.

28 mars

Goditet fabrika 'Sloboda' në Çaçak, një prodhues i madh i pajisjeve elektroshtëpiake në Serbi.

1 prill

Granatat godasin një urë midis Novi Sadit dhe Petrovaradinit në Serbi.

3 prill

NATO-ja godet ndërtesa qeveritare në Beograd.

4 prill

Në Beograd bombardohet selia e Ushtrisë Jugosllave.

Shkatërrohet depoja 'Beopetrol' në Beograd dhe Bogutovc në Kraljevë.

Bombardohet depoja e karburantit në fabrikën e kaldajave në Beograd të Ri.

Sulmohet rafineria e naftës në Pançevë.

Sulmohet aeroporti i Sllatinës afër Prishtinës.

Sulmohet 'NIS Jugopetrol' në Smederevë të Serbisë.

5 prill

Goditet një fabrikë e kaldajave dhe rafineria e naftës në Novi Sad.

Goditen depo tjera të 'Naftagas promet' 10 km larg Somborit.

Sulmohet aeroporti kryesor i Beogradit.

Goditet 'NIS Jugopetrol' në Prishtinë.

Goditet një fabrikë e duhanit në Nish të Serbisë.

Goditet fabrika kimike 'Milan Blagojeviq' në Lluçan të Serbisë.

6 prill

Sulmohet depoja e 'Beopetrol' në fshatin Krushë e Madhe në Rahovec.

Sulmohet fabrika e kimikateve 'Milan Blagojeviq' në Lluçan të Serbisë.

7 prill

Bombardohet depoja e 'Jugopetrol'-it në Sombor të Serbisë.

Bombardohen disa lokacione në Prishtinë dhe në Novi Sad të Serbisë.

8 prill

Sulmet e NATO-s vazhdojnë në Kraljevë, mbi objektet qeveritare në Beograd dhe qytete përreth.

9 prill

Aeroplanët e NATO-s bombardojnë kompaninë 'Zastava Automobili' në Kragujevc të Serbisë, 'NIS Jugopetrol'-in në Smederevë dhe transmetuesit e RTS-it në majën e Goleshit, pranë aeroportit të Prishtinës.

10 prill

Bombardohen aeroportet e Prishtinës, Nishit dhe Kraljevës.

11 prill

Sulmohet kompleksi malor 'Divcibare' afër malit Zlatibor dhe një zonë banimi në Novi Sad.

12 prill

Bombardohen disa lokacione në Kosovë dhe në Serbi, në mesin e tyre një tren, depoja e 'Jugopetrol'-it në Prishtinë, një hotel në Kopaonik të Serbisë. Sulme të tjera në depo naftë në Novisad, Pançevë dhe Kragujevc.

13 prill

Sulme të tjera në depo naftë në

Kosovë dhe Serbi.

14 prill

Goditet gabimisht një kolonë me civilë në Kosovë.

Sulmet vazhdojnë në Prishtinë, kryesisht mbi depo naftë.

15 prill

Sulmohen disa lokacione në Serbi.

16 prill

Sulmohet sërish rafineria e naftës në Pançevë dhe ajo në Novi Sad.

18 prill

Sulmohen disa lokacione në Pançevë të Serbisë, por edhe të tjera në afërsi të aeroportit të Sllatinës në Kosovë.

19 prill

Sulmohet një lokacion në Suboticë dhe fabrika e kimikateve në Bariç të Serbisë.

Shkatërrohet transmetuesi i komunikimeve afër Prishtinës.

20 prill

Sulmohen minierat e thëngjillit në Bardh në afërsi të aeroportit të Sllatinës, në periferi të Prishtinës.

Bombardohen objekte qeveritare në Prishtinë dhe një rafineri e naftës në Novi Sad.

21 prill

Sulmohet selia kryesore e Partisë Socialiste të Serbisë në Beograd të Serbisë.

22 prill

Sulmohet një nga rezidencat e presidentit të Jugosllavisë, Slobodan Millosheviq.

Sulme në Prishtinë dhe Novi Sad.

23 prill

Bombardohet Radio Televizioni i Serbisë – RTS, në Beograd. Sulmohet një urë në Novi Sad dhe lokacione të tjera në Serbi.

25 prill

Sulmohet zona industriale në Nish.

26 prill

Bombardime në Sombor, Novi Sad, Nish dhe Kragujevc të Serbisë.

Sërish bombardohet aeroporti i Sllat-

inës në Kosovë.

27 prill

Bombardime të rënda në Beograd dhe Surdulicë në Serbi.

Në Kosovë: bombardime në Sllatinë, Deçan, Pejë, Lipjan.

8 prill

Bombardohet rafineria e naftës në Novi Sad, një transmetues televiziv në majën Frushka Gora, dhe bombardohet një depo naftë në qytetin Pozhegut.

Në Kosovë bombardohet një lokacion në Mitrovicë, Prishtinë dhe miniera në Stantërg.

Një granatë bie gabimisht në Sofje të Bullgarisë.

Bombardohet një pjesë e aeroportit të Gollubovacit, afër Podgoricës në Mal të Zi, si dhe në Bar dhe Bijelo Polje.

30 prill

Bombardohen objekte qeveritare në Beograd.

Bombardohet ura mbi lumin Lim në Murino, Mal të Zi.

1 maj

Gabimisht bombardohet një autobus i Nish Express-it në urën e Lluzhanit, në periferi të Prishtinës.

2 maj

Bombardohet kryesisht rrjeti i energjisë elektrike.

Goditet një autobus në Pejë dhe një depo naftë në Prishtinë dhe Rahovec.

Bombardohet një seli e RTS-it dhe rafineria e naftës në Novi Sad.

5 maj

Bombardohet sërish 'Jugopetrol'-i në Nish.

7 maj

NATO-ja gabimisht bombardon Ambasaden e Kinës në Beograd. Vriten tre gazetarë kinezë.

Sulme të rënda në Nish.

Bombardohet një urë rrugës që çon në Rumani.

8 maj

Sulme intensive në Beograd, kryesisht mbi rrjetin elektrik.

10 maj

Bombardohet fabrika e kimikateve 'Prva Iskra' në Bariç.

13 maj

Bombardohet një lokacion në Korishë



të Prizrenit. NATO-ja thotë se aty ishte një vendkomandë e ushtrisë dhe policisë serbe. Vriten dhe lëndohen shqiptarë lokalë.

14 maj

Bombardohet një kamp refugjatësh në magjistralen Prishtinë – Prizren, afër fshatit Korishë.

15 maj

Bombardohen depot e 'Jugopetrol' -it në Bor dhe Beograd.

17 maj

Bombardohet sërish 'Jugopetrol' -i në Bor.

19 maj

Bombardohet depoja 'Jugopetrol' në Beograd.

20 maj

Sulmet ajrore dëmtojnë rezidencat e ambasadorit të Zvicrës, Spanjës, Suedisë, Norvegjisë, Hungarisë në Beograd.

Dëmtohet edhe Ambasada e Libisë, si dhe objekti i misionit diplomatik të Izraelit.

21 maj

Goditet rrjeti përçues i energjisë elektrik në Nish.

22 maj

Goditet dhe dëmtohet rrjeti elektrik në Beograd dhe pjesë tjera të Jugosllavisë.

23 maj

NATO-ja fillon bombardime intensive të rrjetit elektrik. Shumë qytete mbesin pa rrymë dhe pa ujë.

24 maj

Bombardohet rëndë fabrika 'Millan Bllagojeviq' në Lluçani të Serbisë.

27 maj

Bombardohet depoja e naftës 'Jugopetrol' në Bor.

Sulmohet rrjeti elektrik në Beograd.

30 maj

Bombardime në Beograd, në një urë në Serbinë qendrore dhe sanatoriumi në Surdulicë.

31 maj

Bombardohen transmetuesit në Nish.

10 qershor

NATO-ja ndërpret sulmet ajrore ndaj Jugosllavisë.

OKB-ja miraton rezolutën 1244 që parasheh vendosjen e një administrate ndërkombëtare në Kosovë.

Fillon tërheqja e trupave serbe nga Kosova.

**Kundërpërgjigja serbe**

Ushtria serbe tentoi t'u kundërpërgjigjej sulmeve ajrore të NATO-s. Sipas dokumenteve, brenda Kosovës u përdorën sistemet individuale me rreze më të gjatë për të qëlluar në aeroplanët e NATO-s në një mënyrë të paparashikueshme.

Armatimi i përdorur për të sulmuar

aeroplanët ishte me rreze të shkurtër, si dhe me sisteme të lëvizshme të mbrojtjes ajrore.

Në një raport të NATO-s thuhet se në vend që të zhvendosnin përpjekjet kundër këtyre sistemeve serbe, komandantët e NATO-s zgjodhën të operonin në lartësi përtej të cilave shumica e sistemeve kundërajrore serbe nuk mund të ishin efektive.

Tentimi i ushtrisë serbe për t'u fshehur

Të përballura me sulme intensive nga ajri, trupat ushtarake serbe mundoheshin që gjatë fushatës së bombardimeve t'i hutonin pilotët e NATO-s.

Ata bënëin kamuflime të ndryshme përfshirë këto si në fotografitë në vijim:

Këto metoda kamuflazhi paraqiten në një raport të vitit 2000 të Departamentit amerikan të Mbrojtjes që shpjegon organizimin dhe qëllimin e bombardimit të Jugosllavisë.

"Serbët përdorën gjerësisht kamuflimin për të fshehur objektivat taktike, si automjetet ushtarake, dhe objektet fikse, si urat. Përveç kësaj, serbët përdorën mashtrime...për të krijuar një sërë objektivash false", thuhet në këtë raport .

Efikasiteti i sulmeve

Pas përfundimit të Operacionit të Forcave Aleate, NATO lëshoi një vlerësim paraprak të efektivitetit të sulmit të saj kundër një numri objektivash.

**Këto objektiva të shkatërruara ose të dëmtuara dukshëm përfshinin:**

- 11 ura hekurudhore
- 34 ura autostrade
- 29 për qind e të gjithë depozitimit të municionit serb
- 57 për qind e rezervave të naftës
- Të gjitha rafineritë jugosllave të naftës
- 14 poste komanduese
- Mbi 100 avionë
- Dhjetë fusha ajrore ushtarake
- Aeroplanët që garantuan suksesin e NATO-s

Duke pasur shumë shtete anëtare dhe aeroplanë të shumtë në dispozicion, në një raport të NATO-s të vitit 2000 përmenden tri lloje aeroplanësh që kanë luajtur rol kyç në suksesin e bombardimit të Jugosllavisë. Në fushatën ajrore ishin përdorur edhe dronët.

Në vijim janë tri modele që janë përkthyer si kyçe për sukses nga NATO-ja.

Është një aeroplan me një pilot, me shumë role që mund të marrë imazhe fotografike ose radar, si dhe të monitorojë komunikimin e armikut dhe të gjejë burimet e sinjaleve elektronike.

Bombardimet e gabuara

Bombardimet e NATO-s nuk ishin gjithmonë të sakta. Ato shkaktuan viktima edhe në mesin e civilëve, si në territorin e Kosovës, po ashtu edhe në Serbi.

Në vitin 1999, vetë NATO-ja vlerësoi se bombardimet kishin shkaktuar rreth 520 viktima civile.

Në disa raste pilotët e NATO-s sulmuan gabimisht caqe që shkaktuan dhjetëra viktima.

Më 14 prill 1999, një incident i tillë ndodhi në periferi të Prizrenit, kur nga bombardimi i NATO-s u vranë mbi 80 civilë shqiptarë.

Një bombardim tjetër i gabimshëm i një autobusi mbi urën e Lluzhanit në magjistralen Prishtinë – Podujevë, vrau rreth 40 civilë, shumica shqiptarë.

Më 5 prill 1999, dhjetë civilë u vranë gjatë një sulmi në kompleksin ushtarak Aleksinac "Deligrad" në Serbi dhe 30 u plagosën.

Më 12 prill, u bombardua një tren në Ristovac që udhëtonte drejt Beogradit duke lënë të vranë 20 persona.

Më 23 prill, nga sulmi i NATO-s mbi RTS-in në Beograd u vranë 16 civilë.

Në prill, po ashtu, u vranë 11 civilë në Surdulica të Serbisë.

Në Murino të Malit të Zi vriten gjashtë civilë më 30 prill.

Në fillim të majit në Nish të Serbisë vriten 14 civilë.

Këto janë vetëm disa nga incidentet dhe nuk paraqesin të gjitha rastet kur bombardimet e pasakta të NATO-s vranë civilë, si në Kosovë, ashtu edhe në Serbi e Mal të Zi.

Pas 78-ditësh të sulmeve, bombardimet u ndërprejnë më 10 qershor 1999, me Marrëveshjen Teknike të Kumanovës, e cila parashihte tërheqjen e të gjitha forcave ushtarake dhe policore serbe nga Kosova.

Marrëveshje u pasua me miratimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Kjo Rezolutë, ishte një kompromis i pesë vendeve të përhershme anëtare të Këshillit të Sigurimit në bazë të së cilës, në Kosovë vendosej një administratë e Kombeve të Bashkuara – UNMIK, e cila administronte fazën transitore deri në ngritjen e institucioneve vendore dhe zgjidhjen e përhershme të statusit të Kosovës.

Më 12 qershor 1999 filloi vendosja e rreth 50,000 ushtarëve nga 36 vende të botës, prej të cilëve 30,000 ishin nga vendet e NATO-s.

KFOR-i është i pranishëm edhe sot dhe kujdeset për sigurinë e Kosovës.

ARTAN HOXHA

Me sa duket Erion Veliaj do t'i kalojë në burg ditët, javët e muajt e hetimit SPAK-ist, si kryetar i zgjedhur, por pa firmë e vulë, të paktën deri kur kjo gjendje - i vdekur (politikisht) por i pakallur - do t'i interesojë Edi Ramës.

Bazuar mbi precedentët, Rama mund ta shkarkojë kur të dojë me vendim qeverie por, hë për hë atij i intereson kjo gjendje, aq më shumë që e mposhti me lehtësi "kryengritjen 24 orëshe" të Veliajt, i diktoi rikthimin e firmës dhe vulës tek nënkryetaria Ristani dhe e detyroi të pohonte me gojën e vet se kishte "gabuar pa dashje për shkak të izolimit".

Rasti Veliaj, si kombinim i procesit penal me atë politik, plotëson pamjen dhe i jep përgjigje pyetjes se çfarë është në të vërtetë drejtësia e re, në veçanti SPAK/BKH/GjKKO. Pyetja shtrohet në veçanti për këto tre organe se, sa për pjesën tjetër: gjykatat e rretheve gjyqësore dhe prokuroritë, Gjykata e Apelit e deri ajo e Lartë dhe Kushtetuese, apo Prokuroria e Apelit dhe ajo e Përgjithshme, bashkë me organizmat qeverisës të sistemit të drejtësisë si KLGj, KLP, ILD, KED, e deri tek Shkolla e Magjistraturës apo Policia e Shtetit, janë ashiqare zgjatime të mazhorancës rilindëse.

Për SPAK/BKH/GjKKO deri tani gjallojnë pesë hipoteza:

Më së pari hipoteza e artikuluar fort e me zë të lartë nga Sali Berisha, se SPAK/BKH/GjKKO janë organizata kriminale e në shërbim të Edi Ramës. Hipotezën e tij Sali Berisha e mbështet në shumë fakte dhe indicie, bërë publike prej tij dhe të tjerë, e që tregojnë se ka shumë persona të inkriminuar brenda këtyre strukturave dhe nuk ka veprime vetëpastrimi e, ndërsa lidhjet me qeverisjen rilindëse janë të dukshme njëherazi sjellja e tyre është fortësisht antiopozitare. Edhe nëse Sali Berisha nxitohet në konkluzion, ai nuk gabohet në alarm.

Një alarm të këtitillë e kanë dhënë edhe disa vëzhgues dhe analizues të kriminalitetit, fare të palidhur me demokratët, kur kanë pohuar në disa studio televizive a shkrime se nëse publikohen të gjitha përgjimet e nxjerra nga rrjetet e inkriptuara, ardhur nga Franca, Belgjika apo Spanja, bie moralisht e gjithë reforma në drejtësi për shkak të përfshirjes në kësi afëra të personave kyç në të gjithë sistemin.

Pra, edhe nëse ende jo organizata kriminale, këto struktura, me këtë përbërje të molepsur si dhe me fuqinë e madhe e të plotë dhe kontrollin shumë të dobët, mund të përfundojnë, herët a vonë në të këtitilla.

Hipoteza e dytë është ajo që kam lëvruar vetë, por edhe disa të tjerë krahas meje, ajo që SPAK/BKH/GjKKO janë jetësuar bashkërisht si bashkëpunim i qeverisë me ndërkom-bëtarët, së pari amerikanët e, që në



gjenezë e në vijimësi brenda këtyre strukturave kanë vepruar dy linja ndikimi, ajo qeveritare dhe ajo ndërkom-bëtare. Meqenëse, për arsye gjeopolitike apo si orientim neoliberal, e deri tek arsyet banale të interesit imediat, ndërkom-bëtarët kanë përkrahur Edi Ramën dhe kanë goditur Sali Berishën, këto dy linja kanë bashkëvepruar me dëshirë dhe harmoni në rastet e goditjes së eksponentëve të opozitës.

Lidhur me goditjet ndaj eksponentëve të Rilindjes, që nga Tahiri e deri tek Veliaj, goditjet janë bërë qoftë se zulumet kane plasur sheshit e nuk mund të shmangeshin, qoftë se pushteti që forcohet duke goditur opozitën ka nevojë edhe për lustrën e vetvetes, qoftë që edhe vetë SPAK/BKH/GjKKO kanë nevojë të "kafshojnë nga të rilindjes" që të fitojnë autoritet për "kafshuar nga të opozitës".

Në këtë hipotezë, i vetmi i paprekshëm, e që fuqizohet e lustron nga paprekshmëria, është Edi Rama. Të gjithë të tjerët, kundërshtarët dhe bashkëpunëtorët, armiqtë dhe miqtë e tij, janë të prekshëm sipas rastit dhe nevojës së fuqizimit dhe/ose lustrimit të pushtetit të tij. Së fundmi, pasiviteti amerikan ka krijuar një gjendje paqartësie ndërsa po tentohet që vakuumi, në mungesë të gjatë a të përherëshme të amerikanëve, të plotësohet nga qeveria aq edhe nga BE-ja neoliberale në fërkim politik me Amerikën trumpiane.

Hipoteza e tretë është ajo e "dashnorë(e)ve të sinqertë" të SPAK/BKH/GjKKO, sipas të cilës këto organe janë të pavarura nga qeveria, mbështeten e mbrohen nga ndërkom-bëtarët dhe janë në rrugë të mbarë në luftën kundër korrupsionit dhe kriminit të organizuar duke goditur pa dallime politike, më shumë qeverinë.

Ndërsa përdor si argument rastet e shumta të hetimit apo dënimit të eksponentëve qeveritarë, kjo hipotezë nuk i jep dot shpjegim pyetjes se pse nga këto organe nuk ka ende asnjë hetim ndaj Edi Ramës, as emrin nuk guxojnë t'ia përmendin në shkresat në çështjet ku ai shfaqet me rol, ndërsa, po të zbatohet prej tyre "standardi Berisha" pra të dyshohet edhe për amendime ligjore me motive korrup-tive, për Edi Ramën gjen me qindra të këtitilla, mjaft të fusin dorën në thes.

Hipoteza e katërt është ajo e vetë Edi Ramës që mburret se reformën në drejtësi e ka bërë ai, e se është ai garanti, aq me shumë tani që na lanë edhe amerikanët. Së fundmi, që pas arrestimit të Veliajt, ka rënë në sy ngrohtësia e tij për Dumanin, beniaminin e amerikanëve të larguar tashmë e të europianëve me ne afrim, të cilin nuk le rast mos ta lëvdojë, mos t'ia qajë hallin që e sulmon familjarisht kënetat politike e mediatike dhe mos ta garantojë se veç ai e mbron prej atyre, përfshirë nga rilindësit e tërbuar që i ka për kollaj – toga mbllidhu, toga shpërndahu. Edi Rama

mburret se i ka dhënë shpatën drejtësisë – e paparë dhe e pabërë ndonjëherë në historinë e shtetit shqiptar – pranon se ajo nuk i ka sytë e lidhur, por me gjak dhe peshoren hiç në terezi, siç do të duhet t'i kishte, por do merret ai me rregullimin e këtyre çështjeve përgjatë rrugëtimit drejt BE mjafton që shqiptarët ta votojnë masivisht me 11 maj. Se si mund të quhet drejtësi ajo gruaja me shpatë, me sy me gjak dhe peshoreprishur, vec Edi Rama mund ta thotë e të mburret se ç'është bërë. Një pyetje lind këtu për dashnorë(e)t e kësaj drejtësie të re, ata/ato të hipotezës së tretë. Si ka mundësi që dashurojnë kryeveprën e Ramës, ndërsa shajnë Edin?!

Hipoteza e pestë shndriti për fare pak, si meteor, në ditën kur u arrestua Erion Veliaj deri të nesërmen kur foli Edi Rama.

Disa medie dhe analistë majtistë, mbështetës të Veliajt njëherazi të Ramës, e hodhën atë mbrëmje, në panik e sipër, hipotezën se SPAK, me arrestimin e Veliajt, po ndërhyr rëndshëm në procesin zgjedhor të 11 majit, haptazi kundër qeverisë. Që prej momentit kur foli Edi Rama e deri më sot kjo hipotezë nuk ka ngritur më krye. I qetësoi. E vetëkuptueshme.

\*\*

Reforma e Drejtësisë rezultoi një kryqëzatë kundër saj. Në gjithë sistemin e zakonshëm të prokurorive e gjykatave, kohëzgjatja e çështjeve

është shumëfishuar, dosjet stok gjithashtu. Para reformës, e si argument për kryerjen e saj u përdor stoku i afro 35 mijë dosjeve të prapambetura gjithsej, tashmë ato janë rreth 150 mijë.

Ndikimi politik, një tjetër argument për reformën, jo vetëm që nuk është dobësuar por nga pluralist është bërë monist, në ndihmë të fuqizimit e lustrimit të pushtetit në një dorë të Edi Ramës. Për rrjedhojë as cilësia profesionale e drejtësisë nuk është rritur as ndershmëria dhe paanësia e saj.

World Justice Project, në raportin e vitit 2024, na zbriti në vendin e 101-të në vitin 2024 kundrejt vendit të 55-të që mbanim në 2015-ën lidhur me drejtësinë civile dhe respektivisht në vendin e 92-të kundrejt atij të 46-të në drejtësinë penale, e ku rënia ka qenë e përvitshme, pak e nga pak, në pozicion dhe pikavarazh, dora-dorës formësohej drejtësia e rilindur.

Gjendja nuk është më mirë edhe në segmentin e posaçëm SPAK/BKH/GjKKO. Rezultatet e tyre kundër kriminit të organizuar në këto pesë vitet e para të ekzistencës, ndonëse me mbështetje të shumëfishuar financiare e burimore të tjera, janë më të pakta në krahasim relativ me rezultatet spektakolare të Prokurorisë dhe Gjykatës së Krimeve të Rënda në pesë vitet e para të veprimtarisë së tyre.

Pavarësia e SPAK-ut kundrejt qeverisë nuk ka arritur as nivelin kur Prokurorë e Përgjithshme ishte Ina Rama dhe drejtues i Task-Force antikorrupsion ishte Altin Dumani, kohë kur prokuroria guxoi të akuzonte me qindra zyrtarë e deri ministra në detyrë apo menjëherë pas largimit (Basha, Rusmali, Mediu, Meta, Pango) e për disa prej të cilëve hyri në konflikt të hapur me qeverinë e kohës, ndërsa SPAK mezi arriti, mbas kaq shumë hezitimesh, tek Veliaj në detyrë, ndërsa duket fare qartë tashmë se erdhi deri këtu për shkak të pëlqimit dhënë me kohë nga vetë Edi Rama i cili, për arsyet e veta të kuptueshme, ka planifikuar ta "vrasë politikisht" Veliaj shumë kohë me parë, qëkurse ky, me historitë dhe ambiciet e veta, iu bë më shumë barrë se ndihmë.

Drejtësia duhet reformuar nga e para. Drejtësi vetëm me shpatë dhënë nga Rama e që vepron me sytë dhe peshoren e Edi Ramës nuk është drejtësi, por diktaturë.

Po ndodh ditë pas dite. Edhe Roma nuk u ndërtua në një ditë, as diktatura e Ramës. Ndaj, duhet ndalur paqësisht, me votë masive kundër tij, sa jemi ende në kohë.

ANDI BUSHATI

# SPAK MES RAMËS DHE VELIAJT

Prej më shumë se një muaji, që kur SPAK u paraqit në zyrat e bashkisë, për ti vënë prangat kreut të saj, një pandehmë po qarkullon në tryezat mediatike dhe në qarqet politike: kush qëndron pas arrestimit të Erion Veliajt?

Ka nga ata që e shohin me besim dhe optimizëm veprimtarinë e prokurorëve të posaçëm.

Ata e konsiderojnë tërë këtë që ndodhi si një rrjedhë normale të drejtësisë së re, e cila është bazuar vetëm tek faktet dhe provat për të shkuar drejt burgosjes së ish delfinit të Ramës.

Ekziston një teori tjetër, disi më konspirative, që e lidh goditjen e fortë të SPAK me ndryshimet drastike që ndodhën pas 20 janarit në Uashington.

Sipas saj, fakti që në qendër të perandorisë po fryjnë erëra anti sorosiste, i detyroi prokurorët e posaçëm të kryejnë një akt të fortë, për të pastruar nga kostumet e tyre njollën pesë vjeçare që kishin marrë mbi vete. Dhe çfarë mund ta arrinte më mirë këtë qëllim sesa goditja e dashnorit politik të Aleks Sorisit në Tiranë?

Ka dhe një teori të tretë, sipas të cilës, asgjë nuk ka ndryshuar dhe thjeshtë Erion Veliajt e ka çuar drejt burgut Edi Rama, ashtu siç ka bërë më parë me Kokën, Ahmetajn, Dakon etj.

Për arsye që ende mbeten mister, eliminimi i delfinit të tij mund të jetë bërë qoftë prej pengesës psikologjike për të bashkëjetuar me një pasardhës, qoftë se i trembej pabesisë proverbiale të Lalit, apo qoftë edhe për të vijuar me politikën e tokës së djegur, të një partie ku ka vetëm bari dhe pastaj thjeshtë një kope me anonimë.

Ndonëse për secilën nga këto hipoteza mund të gjesh argumenta pro



dhe kundër, ditët e fundit, kjo e treta, pra se SPAK ka vepruar me lejen e Ramës, apo i frymëzuar prej tij, po përforcohet gjithnjë e më shumë.

Përplasja e ndodhur të mërkurën mes kryeministrit dhe kryetarit në detyrë, se mbështetësit të cilit prej tyre do ti dorzoheshin çelsat e institucionit, është një tregues ulëritës i betejës që ka shpërthyer.

Kur Rama ia beson bashkinë Anuela Ristanit dhe më pas Veliajt e shkarkon atë për të vendosur si drejtuese zv/kryetaren tjetër, një besnike të tij si Sara Goxhaj, kur kërcënohen mbështetësit e secilës palë me pushime nga puna, kur situata qesharakëzohet deri aty sa policia e njërit apo tjetrit mos lejojë rivalët të futen në zyra, kjo do të thotë se gjërat kanë shkuar shumë larg.

Por ka edhe më. Nëse rrëmon në këtë drejtim kujtohesh me lehtësi se në ditët menjëherë pas arrestimit, mediat pranë Veliajt, njëkohësisht edhe mbështetëse të Ramës, akuzuan hapur Belinda Ballukun, se qëndronte pas dëshmisë së Nesti Angonit dhe se e pati furnizuar atë me prova që mund të nxirreshin vetëm nga institucionet e drejtuara prej saj.

Po sikur ky pretendim të ish i vërtetë, a mund ta bënte Bela këtë pa bekimin e padronit? Po Ulsi Manja dhe vartësit e tij në drejtorinë e burgjeve, a nuk njoftuan "ma nalt" se i burgosuri më i famshëm i burgut të Durrësit ishte vënë në përgjim? Kush e mori vendimin që Veliajt të mos njoftohej për këtë kurth, për të garantuar edhe më qëndrimin e tij në burg?

Po Etjen Xhafajt kush i bërtiti: STOP për të vijuar me mbrojtjen e kryebashkiakut? Po protestat para SPAK-kut kush i ndërpreu, pasi mbaruan dy tre ditët e lotëve të krokodilit?

Po mbështetësit e Lalit kush i spastroi nga lista fituese e Tiranës?

Pra sherri i hapur i mesnatës të së mërkurës para se të jetë një rastesi, ngjan si epilogu i një startegjie të menduar mirë.

Dhe nëse kjo logjikë qëndron atëherë arrestimi i Veliajt nga SPAK nuk është më as një akt pavarësie, as një çështje provash apo faktesh.

Ai përfton formën e një deja vu-je të prangosjeve të pëparshme të zyrtarëve të lartë, duke mos e ndryshuar

aspak dyshimin për një drejtësi me regji.

Poqese Edi Rama ka shkelur syrin apo ka dhënë urdhrin për ta zhdukur atë të cilit i pëlqente të aktronte pasardhësin kjo do të tregonte se asgjë nuk ka ndryshuar.

Por, tani për tani, këto janë vetëm dyshime.

Ajo që dihet me siguri është se udhëheqësi e ka shirur tashmë Lalin. A ka nisur kjo vetëm tani, si pasojë e rethanave të reja, apo ka qenë pjesë e një plani të mirëmenduar më parë, është ende e vështirë të thuhet.

Por nëse kjo pandehmë forcohet është koha që kori i aryre që brohorasin pro SPAK, ta ulë pak frekuencën e kordave zanore.

## POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

### Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:  
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:  
020 7018 7929  
073 4066 5946



LUAN RAMA

Janë ca jugosllavë të mbetur në Prishtinë. Kanë qenë më shumë. Tani janë më pak, shumë më pak. Por, prapë aty janë. Në Prishtinë. Shpesh vijnë edhe në Tiranë. Se gjejnë edhe në Tiranë ndonjë si vetja e tyre.

Ishin kundër luftës çlirimtare të UÇK-së. Kanë qenë edhe kundër pavarësisë së Kosovës. Se kundër gjuhës shqipe si gjuhë e nënës dhe gjuhë zyrtare në Kosovë e kundër flamurit kombëtar kuq e zi, kanë qenë edhe më herët se të ishin kundër UÇK-së dhe luftës së saj për çlirimin e Kosovës.

Njihën. Njihën e dallohen. Përveçohen prej të gjithëve. Janë të ngjashëm me serbët. Ose më saktë, janë si serbët. Vetëm se për dallim prej serbëve, flasin edhe shqip. Flasin shqip, edhe pse mendojnë serbisht.

Reshje dëbore në Veri/ Makinat qarkullojnë me vështirësi në aksin rrugor Bogë-Theth. Nuk kanë marre. As fytyrë nuk kanë. As skuqen e as zverdhen. Enden rrugëve të Prishtinës. Edhe kur shfaqen ekraneve të televizioneve a kur e venë surratin nëper portale, ata janë të njëjtët; janë jugosllavët e mbetur në Prishtinë. Tregohen me gisht. Njësoj siç tregohet e keqja. Për ta ditur se ku është e prej nga vjen. Për ta shquar e për të mos e lënë të avitet.

Shfaqen herahershëm. Më shumë kur i cytin me u shfaq. Por, edhe kur nuk i cytin cytësit në Beograd, prapë ata shfaqen.

Siç u shfaqën dhe iu sulën kohëve të fundit Etnikut tonë. Se në Serbinë, ku këta jugosllavët e mbetur në Prishtinë gjejnë Jugosllavinë që ju mungon, dikush i mban dhe i cyt të bëjnë pikërisht atë që këta bëjnë.

Morën gurët e urët e zjarrit dhe u ndërsyen për të vlarë djalin prej Malisheve, Etnik Brruti. E quajtën tradhëtar.

Sepse, njësoj siç mund të zgjidhte të luante me ekipin përfaqësues të futbollit të Kosovës, zgjodhi të luajë për ekipin kombëtar të Shqipërisë.

Zgjodhi fanellën Kuq e Zi dhe flamurin kombëtar, në ngjyrat e të cilit është po aq sa Shqipëria edhe Kosova. Siç kanë qenë që prej “kur s'kish kufi, as fqinjëri, as shkja të zi”.

Etniku qëllloi të jetë nga Malisheva. Por, mund të ishte njësoj dhe i njëjti shqiptar edhe nga Shkodra, nga Malësia e Gjakovës këndeje e andej, prej Kaçanikut a prej Labërie, prej Konispolit të Çamërisë po aq sa prej Luginës së Preshevës, Tetovës, Dibrës së Madhe e të Vogël, Komanovës, Hotit e Grudës, Ulqinit e Tiranës.



Sepse ne “jem’ një komb, m’u da s’-duron”.

Ata, jugosllavët e mbetur në Prishtinë, nisën të gogësinjë. Vollën dhe pëgërën kutërbueshëm.

E quajtën tradhëtar Etnik Brrutin, ata që tradhëti e kanë gjithë jetën dhe qenien e tyre.

Por, ligësia, helmi, urrejta dhe e keqja e tradhëtia e tyre nuk është kundër Etnikut. Ata, jugosllavët e mbetur në Prishtinë, vetëm sa e përdorën Etnikun.

E përdorën për të na thënë se janë aty. Në tokën tjetër. Se për ata, jugosllavët e mbetur në Prishtinë, Kosova është toka tjetër.

E përdorën zgjedhjen e zemrës së Etnik Brrutit, për të na thënë se ata janë aty. Në kombin tjetër. Se për ata, jugosllavët e mbetur në Prishtinë, Kosova është kombi tjetër.

Kombi kosovar. Gjuha kosovare. Identiteti kosovar.

Po, është e vërtetë se përveç Shqipërisë, në Ballkan e ngjitur me të, ekziston edhe një shtet tjetër i shqiptarëve, Kosova.

Por, Kosovën e bënë shtet shqiptarët,

gjaku i tyre, rezistenca, lufta e shqiptarëve. Jugosllavët e mbetur në Prishtinë ishin kundër. Dhe janë kundër edhe sot. Kundër Kosovës dhe kundër Shqipërisë.

Të dy shtetet, Shqipëria dhe Kosova flasin të njëjtën gjuhë, gjuhën shqipe. Ndër më të lashtat e gjuhëve të Botës ku jetojmë.

Ajo është shenja e parë e identitetit tonë kombëtar. Është edhe elementi i parë përbashkues e që na bën të dallueshëm prej të tjerëve rrethrotull nesh.

Në të dy shtetet jeton i njëjti popull, populli shqiptar. Dhe të dy shtetet, Shqipëria dhe Kosova janë i njëjti komb, kombi shqiptar.

Pra nuk jemi dy, por jemi një popull. Nuk jemi dy, por jemi një komb. Nuk flasim dy, por flasim një gjuhë. Nuk kemi dy, por kemi një histori. Kemi një kulturë. Kemi të njëjtat legjenda, të njëjtat përralla. Kemi doke e tradita përbashkuese ndër ne shqiptarët, e përveçuese prej të tjerëve përreth nesh. Prej grekëve, serbëve e bullgarëve.

Shteti kosovar, gjuha kosovare, identiteti kosovar janë pjellë e hershme e

serbo-jugosllavëve. Anipse zëdhënësit më të zellshëm të kësaj teze kohëve të fundit janë bërë ata, jugosllavët e mbetur në Prishtinë, ajo përfundimisht është një teori e vdekur.

Është një ëndërr e vdekur. Dhe e varrosur përgjithmonë ditën kur luftëtarët e UÇK-së u betuan që nën flamurin kuq e zi dhe me luftën e tyre do ta bënin Kosovën të lirë. Siç e bënë me një luftë-epope, të pashembullt për kohët e Europës moderne.

Edhe ata, jugosllavët e mbetur në Prishtinë, nuk kanë për të patur tjetër fund, përpos fundit që kanë patur ata, jugosllavët e Kosovës para këtyre jugosllavëve që kanë mbetur ende në Prishtinë.

Kur Indrit Cara i Kavajës dhe si ai, qindra shqiptarë Shqipërie e bashkuan gjakun e tyre me gjakun e sivëllezërve të gjuhës dhe të gjakut, me shqiptarët të Kosovës në luftë për çlirimin e saj, askush nuk e ka çuar nëpër mend se ata, jugosllavët e mbetur në Prishtinë, do ta quanin Etnik Brrutin e Malishevës tradhëtar, vetëm e vetëm sepse në vend të ekipit të futbollit përfaqësues të shtetit të Kosovës, zgjodhi të luajë për ekipin kombëtar të futbollit

shqiptar.

Afërmendsh, për jugosllavët e mbetur ende në Prishtinë, edhe Indrit Cara është tradhëtar.

Tradhëtar, është edhe Isa Boletini, për jugosllavët e mbetur në Prishtinë. Sepse, ai shkoi e iu bë krah Ismail Qemalit, për të ngritur flamurin e pavarësisë në Vlorë.

Gjithë çfarë na u rishfaq ndyrësisht me sulmet dhe akuzat e jugosllavëve të mbetur në Prishtinë, për “tradhëtinë” e shqiptarit me emrin aq domethënës Etnik, vetëm e vetëm se djaloshi prej Malisheve zgjodhi t’i bashkohej Shqipërisë, është ana tjetër e asaj që serbët bënë pak kohë më parë në Banjskë me aktin e dështuar terrorist, ku ra hero Afrim Bunjaku. Afrim Bunjakun nuk e vranë vetëm terroristët serbë. Bashkë me ata ishin edhe jugosllavët e mbetur në Prishtinë.

Jugosllavët e mbetur në Prishtinë, ishin bashkë me serbët edhe në masakrën e Raçakut. Edhe kur e vranë Adem Jasharin me 58 pjestarët e familjes së tij në tokën e shtëpinë e tyre, ata bashkë ishin.

Ashtu si liria, edhe ligësia ka emër.

## DITMIR BUSHATI

Java që sapo lamë u mbyll me protesta të fuqishme anembanë Europës. Serbët, hungarezët dhe gjeorgjianët dolën masivisht në rrugë, duke theksuar një prirje rajonale të qytetarëve që kërkojnë reforma demokratike dhe jetë dinjitoze. Ato kundërshtojnë korrupsionin e kthyer në sistem, njehsimin e shtetit me pushtetin dhe kalcifikimin e jetës politike.

Që prej nëntorit të 2024-ës, Serbia është përfshirë nga protesta të gjera kundër korrupsionit, të shkaktuara fillimisht nga shembja tragjike e çatisë së një stacioni hekurudhor në Novi Sad, që rezultoi në 15 viktima. Kjo ngjarje, që i atribuohet neglizhencës dhe korrupsionit të pushtetit, ndezi zemërimin e publikut. Lëvizja, e udhëhequr kryesisht nga studentët e universiteteve, ka paralizuar jo vetëm jetën universitare, duke rrokur një mbështetje të madhe popullore. Këmbëngulja dhe përmasat e këtyre protestave, më të mëdhatë që nga koha kur Aleksandar Vučić erdhi në krye të punëve të vendit në vitin 2012, kanë nxitur një ndjenjë solidariteti mes të rinjve nga Lubjana në Podgoricë, nga Zagrebi në Athinë.

Studentët në Serbi kërkojnë që ajo të bëhet një vend demokratik ku sundon e drejta dhe jo kulti i një individi. Të zhgënjyer nga politika dhe qëndrimet e zyrtarëve të BE-së, në mbështetje të pushtetit të presidentit Vučić për më shumë se 12 vjet, bie në sy fakti se studentët nuk valëvisin flamujt e BE-së nëpër protesta. Megjithëse Parlamenti Europian miratoi në shkurt të vitit të kaluar një rezolutë kritike për mungesën e standardeve në zgjedhjet e fundit parlamentare të mbajtura në Serbi në dhjetorin e 2023-ës, praktikisht asnjë masë nuk është marrë. BE-ja vijoi ta trajtonte pushtetin e Aleksandar Vučić sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

Po kështu, mund të thuhet se procesi i bisedimeve për anëtarësimin e Serbisë në BE është kthyer në një farsë, ku asnjëra prej palëve nuk e ka seriozisht. Megjithëse i nisur zyrtarisht në 2014-ën, për nga standardet demokratike dhe vlerat që mishëron, Serbia është më larg se ç'është para fillimit të bisedimeve për anëtarësim. Thënë ndryshe, politika e lehtëimit ndaj Serbisë ka dështuar, pasi në harkun kohor të një dekade, ajo nuk është bërë më demokratike, nuk pranon pasojat dhe realitetin e pasluftës në ish-Jugosllavi. Dhe për pasojë, nuk është më paqësore dhe më e besueshme ndaj fqinjëve.

## ERËRAT QË PO FRYJNË NË EUROPË



Në Gjeorgji protestat e kanë zanafilën tek mungesa e zgjedhjeve të lira, dominimi i jetës politike dhe ekonomike nga një parti në pushtet që prej vitit 2012. Beteja për përcaktimin evropian dhe raportet e ndërlikuara me Rusinë janë elementë të rëndësishëm të krizës gjeorgjiane. Shkëndija që ndezi valën e protestave ishin zgjedhjet parlamentare të diskutueshme të tetorit 2024. Ashtu sikurse në rastin e zgjedhjeve parlamentare të Serbisë, muajin e kaluar Parlamenti Europian miratoi një rezolutë kritike ndaj mungesës së standardeve zgjedhore në Gjeorgji, duke kërkuar në të njëjtën kohë, vendosjen nën sanksione të zyrtarëve të rangut të lartë të përfshirë në minimin e proceseve demokratike.

Si kundërpërgjigje ndaj rezolutës, kryeministri Irakli Kobakhidze njoftoi pezullimin e bisedimeve të pranimit të Gjeorgjisë në BE deri në fund të vitit 2028, sikundër refuzimin e ndihmës dhe instrumenteve financiare të BE-së (granteve dhe kredive) që, sipas tij, përdoret si levë presioni. Në të njëjtën kohë, ai theksoi se qeveria e tij do të vazhdojë të zbatojë reformat e kërkuara për anëtarësim dhe se ende planifikon që Gjeorgjia të anëtarësohet në BE brenda vitit 2030.

Megjithëse një vend kandidat për anëtarësim në BE, që prej dhjetorit të vitit 2023, standardet demokratike kanë shënuar kthim pas. Legjislacioni që synon frenimin e ndikimit të huaj, kryesisht në

radhët e OJF-ve dhe kritikëve të pushtetit, konsiderohet si vazhdim i trajektoreve të çimentimit të pushtetit. Në dallim nga serbët, gjeorgjianët valëvisin flamujt e BE-së nëpër protesta, duke besuar si në ballkanasit dikur se, duke u afruar më shumë me BE-në do të jenë në gjendje të mbrojnë më mirë disa standarde dhe vlera demokratike, të cilat BE-ja i mishëron.

Nga ana tjetër, protestat në Hungari janë tregues të funksionimit të pamjaftueshëm të elementëve demokratikë të sistemit edhe kur je anëtar i BE-së, apo nën mbikëqyrje nga strukturat europiane në raport me sundimin e së drejtës. Që prej vitit 2010 në Hungari kemi të bëjmë me dominimin e një partie që kontrollon pothuajse të gjitha levat e pushtetit, ekonomisë dhe mediave. Mirëpo së fundmi, pushteti absolut i Viktor Orbán është tronditur, si pasojë e kundërshtimeve në rritje.

Hungarezët po protestojnë kundër korrupsionit dhe kufizimit të lirisë dhe të drejtave. Lëvizja e re opozitare e drejtuar nga Péter Magyar, dikur njeri i rrethit të afërt të Orbán, sot denoncuesi kryesor i skandaleve korruptive, ka arritur të mobilizojë protesta masive popullore. Si kundërpërgjigje Orbán ka propozuar ndryshime kushtetuese që synojnë frenimin e ndikimit të huaj, veçanërisht duke synuar OJF-të dhe mediat që marrin fonde ndërkombëtare. Ai i konsideron këto entitete si kërcënime ndaj sovranitetit kombëtar, një veprim që

kritikët e perceptojnë si vazhdim i përpjekjeve për të mbytur disidencën dhe për të konsoliduar më tej pushtetin.

Megjithëse vende me karakteristika, gjeografi dhe histori të ndryshme politike, e përbashkëta e tyre qëndron në faktin se pushteti është fituar në mënyrë legjitime, jo me dhunë. Por, me kalimin e kohës dhe sidomos për shkak të jetëgjatësisë së pushtetit, janë shkelur kufizimet që mbajnë në këmbë një sistem demokratik. Pak a shumë në të tri vendet është përdorur një truk i vjetër: fillimisht predikohet ligji për të fituar pushtetin, pastaj përdoret pushteti për të shtrembëruar apo shpërfillur ligjin.

Gjithashtu, rastet e mësipërme na tregojnë se pavarësisht nëse je kandidat apo anëtar i BE-së, procesi i transformimit demokratik jetësohet falë kontributit, ushtrimit të përgjegjësive dhe vigjilencës së qytetarëve, për të mos lejuar prodhimin e një pushteti që nuk kontrollon dot. Jetëgjatësia në pushtet dhe çmontimi një e nga një i mekanizmave të kontrollit dhe ekuilibrit të pushtetit shitet si diçka normale që ka të bëjë me efektivitetin e qeverisjes dhe të mirën e popullit. E vetmja gjë që kufizon pushtetin është vullneti i mirë i tij, çka nuk ka lidhje me përkufizimin e demokracisë. Sepse, siç thotë me të drejtë politologu Adam Pševorski: “Demokracia është një sistem ku disa gjëra duhen lënë të hapura për një shans që demokracia

të përbushë emrin e saj”.

Protestat në Europë, edhe nëse nuk e korrigojnë në vetvete deficitin demokratik të jetës politike, janë një mundësi për shkundjen e stabilokracisë dhe hapjen e një rruge që çon në gjetjen e balancave të reja politike e shoqërore. Situatat e përshkruara më sipër, pavarësisht dallimeve që kanë të bëjnë me veçantinë e secilit vend, në thelb të kujtojnë fabulën e famshme të Goethe-s “Nxënësi i magjistarit”, ku tregohet se si një magjistar ia beson drejtimin e punishtes së tij një nxënësi të ri duke i dhënë disa detyra. Nxënësi vendosi t’ia lehtësojë punën vetes duke përdorur një nga magjitë e magjistarit por që rezultoi në përmbajtjen e punishtes. Nxënësi u detyrua t’i lutej për ndihmë magjistarit dhe vetëm falë ndihmës së tij përmbajtja u ndal. Mësimi që del prej fabulës së shkruar shekuj më parë është i qartë: pushteti duhet të ushtrohet në mënyrë të kontrolluar, ndryshe sjell fatkeqësi.

Prandaj, erërat që po fryjnë në Europë na tregojnë se njerëzit nuk janë më të gatshëm të tolerojnë shkeljen e normave demokratike në këmbim të disa të mirave materiale që ata vlerësojnë. Ata po shkundin themelet e pushtetit jetëgjatë, duke luftuar për demokracinë dhe refuzuar çdo kompromis që nuk i shërben të ardhmes.

Analiza është botim i fondacionit “Friedrich-Ebert”.

MAL BERISHA

# VLERËSIM PËR VEPRËN E BEJTULLAH DESTANIT DHE MBËSHTETJEN E HARRY BAJRAKTARIT

Pak ditë më parë, në Prishtinë, doli nga shtypi një botim me vlera të rralla historike dhe simbolike, i titulluar: "PRESIDENTI W. J. CLINTON – LUFTA E KOSOVËS 1998–1999: FJALIME DHE PARAQITJE MEDIATIKE."

Ky libër i përgatitur me përkushtim nga studiuesi i mirënjohur Bejtullah Destani dhe i mbështetur me vizion e dashuri atdhetare nga z. Harry Bajraktari, përfaqëson një shtesë të paçmueshme në bibliotekën e kujtesës kombëtare shqiptare dhe në testamentin e miqësisë shqiptaro-amerikane.

Me këta dy zotërinj të nderuar më lidh një miqësi e sinqertë e ndërtuar me kalimin e dekadave, që nga vitet '90 të shekullit të kaluar.

Por përtej miqësisë, ajo që më nxit të shkruaj këto rreshta është vepra që ata sjellin në dritë – një akt atdhetarie, dije dhe përgjegjësie historike.

Z. Bejtullah Destani, me punën e tij të palodhur, ka ndriçuar faqet e historisë

shqiptare duke sjellë në botim vepra të autorëve ndërkombëtarë që kanë shkruar me ndershmeri për të vërtetën tonë.

Ai ka krijuar një arkiv monumental, ku ndërthuren kujtesa, dokumenti dhe dinjiteti.

Nuk është thjesht botues – është ruajtës i kujtesës kombëtare dhe ndërtues i urave të dijes midis së kaluarës dhe të ardhmes. Falë tij, historia jonë nuk është më një rrëfim i lënë në harresë, por një burim i gjallë për brezat që vijnë.

Ndërkaq, z. Harry Bajraktari, figura emblematike e komunitetit shqiptaro-amerikan, mbetet një nga shtyllat më të fuqishme të mbështetjes për çështjen kombëtare në arenën ndërkombëtare.

Ai ka ditur të bëjë zërin e shqiptarëve të dëgjohet në zyrat më të larta të politikës amerikane dhe të krijojë ura që përçojnë besim, drejtësi dhe vlera.



Mbështetja e tij për këtë libër është vazhdimësi e një angazhimi të gjatë dhe fisnik për çlirimin dhe konsolidimin e Kosovës.

Rreth librit

Vepra sjell të përmbledhura me saktësi dhe ndjeshmëri historike të gjitha fjalimet dhe paraqitjet publike të Presidentit të Shteteve të Bashkuara, William Jefferson Clinton, gjatë peri-

udhës së luftës në Kosovë, 1998–1999.

Këto fjalime janë më shumë se deklarata politike: ato janë fjalë që morën kuptimin e veprimit, udhëzuan ndërhyrjen ndërkombëtare, dhe ndihmuan në shpëtimin e një populli nga shfarosja.

Presidenti Clinton, në ato ditë të rënda për Kosovën, u bë simbol i shpresës, zë i arsyes dhe mburojë e lirisë.

Ky libër dokumenton me saktësi e ndjeshmëri këtë kapitull jetik të historisë sonë – jo thjesht për të informuar, por për të kujtuar e për të nderuar.

Rëndësia e tij shkon përtej arkivimit: ai është një akt ndërgjegjeje dhe mirënjohjeje, një thirrje për të mos harruar se kush ishim, çfarë përjetuam dhe kush qëndroi pranë nesh. Ai është një dëshmi se fjala, kur del nga goja e së drejtës dhe shoqërohet me veprim, mund të bëhet armë çlirimtare.

Për këtë arritje të lartë, z. Bejtullah Destani meriton vlerësimin më të thellë. Ndërsa z. Harry Bajraktari meriton respektin dhe mirënjohjen e çdo shqiptari që e ndien Kosovën pjesë të qenies së vet.

Ky libër nuk është vetëm një botim: është një akt nderimi, një shprehje e përjetshme mirënjohjeje ndaj një aleati të madh – Presidentit Bill Clinton, dhe një përmendore për forcën e fjalës që bëhet liri.

LUTFI DERVISHI

## 89 HIJET E LUMTURISË

Raporti i Lumturisë e gjeti këtë vit Shqipërinë në vendin e 89-të, një pozicion strategjik mes varfërisë romantike dhe ëndrrës për pasaportë europiane.

Si zakonisht, edhe këtë vit Shqipëria e ka ruajtur ekuilibrin emocional, duke mos rënë më poshtë se vendi i parafundit në Europë. Kemi lënë pas Turqinë, një nga 15 aleatët tanë strategjik.

Por nuk ka vend për panik. Gjërat nuk janë aq keq sa duken. Janë më keq se duken, por në një mënyrë origjinale.

Ata që hartojnë pyetësorët dhe bëjnë vlerësimet nuk e dinë që lumturia këtu është... një sport ekstrem.

Në vendet nordike, njerëzit lumturohen kur aplikacionet funksionojnë.

Këtu, lumturohemi kur qeveria i mbyll aplikacionet.

Për të mos harruar sektorët ku shkëlqejmë si askush tjetër mbi dhë

Për shembull: shëndetësia falas: Futesh në spital me grip dhe del si zotëri jo vetëm me kredi në bankë, por dhe me një mik për kokë që e ke për gjithë jetën, - farmacistin.

Thuaj çfarë të duash, por monotoni nuk i thua dot.

Jeta këtu ofron befasi që në vendet nordike, të parët në renditje, nuk i konceptojnë dot.

Merr shembullin e parkimit. Parkimi, këtu nuk është nevojë, është festival emocional. Kur gjen një vend parkimi, trupi çliron endorfinë më shumë se pas një maratone.

Po kur sheh një fushë me bar? Bar, nga ai i rendomti që hanë lopët! Lum-

turia në këtë çast kaplon tre breza: fëmijët që nuk kane parë ndonjëherë bar, prindërit që nuk kanë pritur ta shohin, dhe gjyshërit nostalgjik për kohën që ishin gati të hanin bar.

Gjyshërit këtu shqetësohen vetëm për një: mos ndoshta ndonjë ditë dikush çmendet dhe u rrit pensionin.

Edhe blerësit ndodh që shqetësohen, por vetëm nëse çmimet ulen. Këtu nis paniku. "Po na e fusin?". Por ky moment trishtimi është po aq i rrallë sa bora në Sarandë. Ketu, njerëzit janë të lumtur dyfish, kur i zhvasin me transparencë.

Dhe si mund të mos përmendim kontribuueset kryesore të lumturisë, qeverinë?

Në çdo vend tjetër, skandinav ose jo, i botës së parë ose botës së tretë, qeveria përpiqet të shmangë skandalet që të ruajë popullaritetin.

Ketu ndodh e kundërta: Kur nuk ka skandale, qeverise i bie popullariteti.

Ndërkohë, Kosova, motra jonë më e re që ka bërë luftë, por ka kaluar me më pak trauma tranzicionin, u rendit e 29-ta në botë për lumturi dhe e para në rajon

Pse? Pyetje e gabuar.

Si? Prapë gabim

Ne e dimë që problemi është te raportit, jo te realiteti.

Gabim janë indikatorët!

Ata masin të ardhurat, mbështetjen sociale, shëndetin, arsimin, lirinë, korupsionin...

Për të qenë i lumtur duhet të jesh pak kreativ. Psh mbrëmë një tifoz vuri



bast që kombëtarja jonë do të humbte përballë Anglisë. Nëse do të fitonte, tifozit do të lumturohej. Shqipëria humbi, por kuqeziu prap u lumturova me leket që fitoi nga basti.

Shkurt. Ne për lumturinë kemi një koncept dhe kut tjetër.

Ata ende nuk e kanë kuptuar se, ne jemi të lumtur që jemi të pakënaqur. Kjo është lumturia jonë kombëtare: një melankoli e stabilizuar, një vetëngushëllim kolektiv, një festë që mbahet me shpenzimet e BE-se

Jo për të fyer nordiket, por siç thotë Balzaku vetëm të paditurit janë të lumtur, ndërsa ne i japim mend gjithë botës.

Lumturia jonë, është një luks ballkanik që asnjë vend nordik nuk mund ta përballojë. Dhe nuk ka se si.

**Ujë ka kudo, përveçse në rubinet!**

Është një ditë e lagësht që vjen pas ditës së verës dhe pranverës. E gjithë java do të jetë me shi.

Qielli është hapur, si ishin deri para pak vitesh grantet e BE -së për bu-

jqësinë.

Shiu bie me rrëke, rrugët janë kthyer në kanale ujëmbledhëse, makinat bëjnë rafting në rrugën "Don Bosko", Durrësi kthehet në Venecia, dhe poetët nisin vjershat me pikat e shiut...si thoshte kënga e vjetër, "E shiu pikë, pikë pikë,..."

Në këtë vend të bekuar nga natyra nga malet, lumenjtë, burimet, liqenet, detrat dhe lotët e qytetarëve, uji është kudo... përveçse në rubinet.

Ne kemi burime ujore për frymë më shumë se çdo vend tjetër në rajon. Kemi burime që shpërthejnë me entuziazëm, kemi lumenj që rrjedhin me dinjitet, reshje që s'kanë ndalur që nga koha e Skënderbeut, por... çezma, kjo krijesë misterioze, jeton në anktë.

Ka ditë që mbushet me ujë, dhe ditë që mbushet vetëm me zëra:

"Po vjen."

"Do vijë sonte."

"Ka një problem te pompa."

"Po punohet ne rrjet."

"Fajin e ka ngrohja globale."

"Fajin e ka Lufta në Ukrainë."

"Po ç'të bëj qeveria më parë."

Premtimi për ujin 24 orë është bërë aq shpesh, aq seriozisht dhe aq bukur, sa goja e votuesit mbetet si ajo e peshkut pa ujë.

Mandati i parë: "Do bëjmë projektin." Mandati i dytë: "Projekti u bë, por po e përmirësojmë."

Mandati i tretë: "Kemi rritur në 67%." Mandati i katërt: do të keni pasaportë të BE dhe mund të pini ujë kudo në Europë".

Por pse të pijmë ujë në Europë dhe jo në Shqipëri, që është në Europë, ku: Ka ujë që del nga toka, por jo nga tubi.

Ka ujë që përmyt qytetin, por nuk mbush banjën.

Ka ujë që vjen në tendera, por jo në depozita.

Ka ujë për të larë ndërgjegjen politike, por jo për të larë një pjatë.

Në dokumenta dhe raporte, humbjet e ujit janë "rrjedhje teknike".

Në shtëpitë tona, janë fatura të fryra që duhen paguar.

Shqipëria sot është vendi ku ka më shumë ujë në Instagram sesa në rubinet.

Dhe ndërkohë... bie shi.

Këpucët janë zhytur në ujë, njerëzit ecin si rosat, të lagur, të qetë dhe pa asnjë shpresë se do të vijë dita që të pinë ujë te rubineti në shtëpi.

Lutjet janë që ndonjë ditë, teksa bie shi, si sot, rubineti të ndjejë xhelozit dhe të vendosë të rrjedhë edhe ai.

Nëse jo ujë për t'u pirë, të paktën për statistikë.

# AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

## E nesërmja fillon tani!

**Dotech**  
websites 

## Jepi frymëmarrje biznesit tuaj!


Adresa e zyrave  
30 Avenons Road  
London E13 8HT

Për çdo konsultim mund te vini  
në çdo kohë në zyrat tona

**Dotech**  
websites 

Na kontaktoni:  
020 7018 7929

Mob:073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



# MBËRRITJA PAS SHUMË PERIPECIVE E ALEKSANDËR MOISIUT NË BUENOS AIRES, INTERVISTA ME GJENIUN E SKENËS BASHKËKOHORE BOTËRORE

AURENC BEBJA

“Diario Crítica” ka botuar, të dielën e 7 prillit 1929, intervistën ekskluzive asokohe me Aleksandër Moisiun në Buenos Aires, të cilën, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Moisiu, tragjiku i madh gjerman, sapo ka mbërritur në Buenos Aires dhe tregon përshtypjet e udhëtimit të tij.

Një udhëtim me probleme. — “Të kryesh tetë funksione. Kam gjashtëdhjetë ditë lundrim. Angazhimet e mëparshme do ta pengojnë tragjedianin e shquar të ofrojë më shumë se tetë shfaqje.

Moisiu ndodhet në Buenos Aires që nga mbrëmë. Pasagjeri nga Cap Arcona zbarkoi sapo u hoqën kufizimet sanitare për anijen transatlantike, i cili megjithatë, po shkurton edhe më tej itinerarin e tij, që është shumë i shkurtër në Buenos Aires për shkak të kontratave të tij në pritje.


Aleksandër Moisiu është i ndjeshëm, do të kalojë si yll në qiellin tonë artistik. Moisiu, siç e kemi thënë tashmë, është një nga figurat kryesore të skenës bashkëkohore botërore. Parisi, Londra dhe Nju Jorku kanë përshëndetur të gjithë figurën tragjike që ka bërë që turmat të dridhen nga emocionet. Francezët, të cilët ishin aq të kursyer në lëvdatat e tyre për të huajin, ishin ata që treguan entuziazmin më të madh në kritikën e tyre, ku disa e shpallën atë gjeni, e të tjerë aktorin më të madh dramatik të gjallë.

Pasi e nisi karrierën e tij në teatër si një ekstra, karriera e tij evropiane dhe triumfi i tij i fundit në Nju Jork kulmojnë me famën e tij aktuale. Gjermano-gjermani tragjik, me gjak hebre, bir i një shqiptari dhe nënë italiane, i lindur në Trieste nën dominimin austriak ? — por gjerman, për shkak të kulturës së tij intelektuale dhe gjuhës me të cilën shpreh temperamentin e tij artistik, ai do të na japë vetëm katër shfaqje të talentit të tij: “Fantazmat”, “Hamleti”, “Dymbëdhjetë mijë” të Bruno Franck-ut dhe “Kufoma e gjallë” e Tolstoit. E pamë mbrëmë duke folur familjarisht në të gjitha gjuhët, duke pritur me ankth kohën e debutimit të tij para një publiku të ri dhe të largët.

Për çdo zotëri, çdo nder. Moisiu është një nga zotërit e artit dramatik. Mos hezitoni të na dërgoni mirëseardhjen tonë të ngrohtë dhe të shprehim kënaqësinë tonë për të ndarë me ju aktivitetet tona teatrale në Buenos Aires.

Moisiu, poliglot

Figura e Aleksandër Moisiut, e konsideruar artistikisht, është mjaft e njohur që ne të përpiqemi ta zbulojmë atë; Fizikisht ai është një njeri me tërheqje të veçantë; Me gjatësi mesatare, i hollë, me një fytyrë të rrumbul-



lakët, të bardhë, me flokë të valëzuar, ngjyrë bronzi, një grimasë ironike në gojë dhe me sy depërtues, këto janë linjat e përgjithshme të këtij lloji që mbushin skenën dramatike në teatrot e mëdha evropiane dhe të Amerikës së Veriut.

Moisiu është një poliglot dhe me fraza në italisht, gjermanisht dhe frëngjisht na tregon odisenë e udhëtimit të tij :

— Për të luajtur tetë ditë në Buenos Aires — do të më duhet të lundroj për gjashtëdhjetë ditë ...

Ndërsa isha në Nju Jork, i dhashë fjalën Urban-it që të vija me të në Buenos Aires. Ideja për t’u njohur me këtë pjesë të planetit të vogël që ne jetojmë më tërthoqi dhe nëse mbaj fjalën e nderit do të më duhet të lundroj për gjashtëdhjetë ditë dhe do të duhet të pres deri në maj për të pranuar kontratën e mrekullueshme që më ofroi një kompani e madhe filmash për të luajtur në dy filma shumë të rëndësishëm, “Kean” të Dumas dhe “Dishepulli i Djallit” të Bernard Show.

Moisiu, aktor filmi (kinemaje)

Këta filma, bazuar në këto vepra të mrekullueshme, do të realizohen duke përdorur një proces modern që po revolucionarizon artin kinematografik sot, ai quhet film që flet (film me zë), dhe siç duket edhe emri i tij, aktori

shihet në të njëjtën kohë kur dëgjohet.

Një udhëtim me probleme

Udhëtimi im ishte vërtet plot ngjarje : për të takuar Urbanin dhe për t’u kthyer në Kaliforni më 15 maj, më duhej të hipja në anijen e parë që nisej për në Evropë në Nju Jork në një ditë kur shpërtheu një stuhi e jashtëzakonshme që nuk na la gjatë gjithë udhëtimit tonë për në Hamburg.

Meqenëse moti i keq na bëri të vonoheshim për rreth 70 orë, nuk munda të shihja familjen time me mbërritjen time në Gjermani dhe nga anija që po më çonte atje shkova drejtpërdrejt në Cap Polonio, në bord patëm një udhëtim shumë të lumtur, por siç thotë thënia e vjetër spanjolle :

“Epo, hajde keq, nëse vjen vetëm”, dhe ja, në brigjet e Brazilit mësuam se do t’i nënshtroheshin një karantine shëndetësore, dhe si pasojë e një vonese të re dhe shtyrjes së pashmangshme të debutimit tim.

Kompania Urban

Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto, shton Moisiu, kompania Urban që udhëton në bordin e Weser-it do të duhet të durojë një karantinë më serioze se e imja, gjë që ka bërë të nevojshme shtyrjen e sezonit përsëri.

Pas performancës sime në Buenos Aires, do të kaloj Andet për të hipur



në një anije në Valparaíso dhe do të arrij në San Francisco, Kaliforni, më 15 maj, sipas fjalës time.

Moisiu do të performojë në Odeón të merkurën me datë 10 prill në shfaqjen “Espectros — Fantazmat”.

**1932/ “Nuk e di nëse teatri gjerman do të mbijetojë nën presionin e censurës...”, intervista me Aleksandër Moisiu në Kopenhagë**

Gazeta norvegjeze “Dagbladet” ka botuar, të premten e 2 shtatorit 1932, intervistën asokohe me Aleksandër Moisiun në Kopenhagë, të cilën, Aurenc Bebja, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Moisiu i frikësohet censurës së teatrit gjerman.

Udhëtimi në Itali me “Faustin” për dimër.

Aleksandër Moisiu, i cili pas pak ditësh do të vijë në Oslo, ku do të jetë i ftuar me shfaqjen “Fausti” në Teatrin Kombëtar, aktualisht po qëndron në Kopenhagë, ku është intervistuar. Kanë kaluar 10 vjet që kur aktori i madh ka vizituar për herë të fundit kryeqytetin danez dhe i pyetur se pse ka kaluar kaq shumë kohë që nga vizita e tij për herë të fundit, ai përgjigjet :

— Vështirë se mund të më akuzoni se jam besdisës. Dhjetë vjet më parë pata një sukses të madh në Kopenhagë, por që atëherë nuk e kam shfaqur veten këtu. Arsyeja nuk është se më është kërkuar të qëndroj larg! Tani, kur krijohet një stil Faust-florestilling, edhe me dy artistë si Bassermann-i dhe Karin Evans, nuk ka gjasa që të më refuzojnë.

— Meqë ra fjala, pse nuk keni qenë këtu për kaq shumë kohë ?

— Nuk e kam zakon të përfitoj nga sukseset. Bota është mjaftueshëm e madhe. Do të doja t’i thosha përsëri-

detje një qyteti si Kopenhagen dhe pastaj të zhdukem përsëri. Ushqimi i ringrohur nuk ka shije të mirë : një aktor duhet të punojë vazhdimisht dhe vetëm kur të ketë arritur pikën e zhvillimit të tij, që mund të tregojë diçka të re, duhet të kthehet prapa.

— A është pakënaqësia me teatrin gjerman që ju shtyn të shkoni në turne ?

— E organizova këtë turne sepse ishte viti i përvjetorit të Gëtes. Mendova se do të ishte kënaqësi të krijohet një turne që nuk kishte vetëm një yll, por përbëhej nga disa aktorë të shquar. Kjo është arsyeja pse unë solla Bassermann-in dhe Karin Evans-in, dhe ne kemi luajtur me sukses të jashtëzakonshëm në Holandë, Belgjikë, Francë dhe Zvicër.

Ju na bëni një pyetje në lidhje me teatrin gjerman. Ne vetë nuk dimë shumë për të. Ne gjithashtu nuk e dimë nëse teatri do të mbijetojë në kohët e ardhshme nën presionin e censurës.

Unë vetë nuk jam më me Reinhardt-in. Kam udhëtuar shumë, duke përfshirë edhe Amerikën, ku kam luajtur në një film të Warner Brothers, një variant i “Keans”, i quajtur “The King’s Lodge”. Më pëlqeu shumë, por nuk kam regjistruar më. Në sezonin e ardhshëm do të luaj në Itali në italisht — siç mund ta dini, jam italian nga lindja. Në një ansambël italian kam ndërmend të performoj me “Faustin” në të gjithë Italinë. Verën e ardhshme kam ndërmend të luaj “Loja e vjetër e të gjithëve” në Sienë, edhe në italisht.

— Ndiheni më shumë si italian sesa gjerman ?

— Unë jam aq kozmopolit në zemrën time sa nuk jam përpjekur kurrë të zbuloj nëse kam ndjerë këtë apo atë. Unë përpiqem të jem një qenie njerëzore më shumë se një kombësi. Në fund të fundit, kombësia është vetëm çështje dokumentesh identiteti.

VETON SURROI

Evropa ka hyrë në përcaktim të identitetit të saj të ri, duke vendosur se çka nuk dëshiron të jetë. Ky proces vetëpërcaktues sot është pak a shumë të qenit në opozitë ndaj Putinit e në panik nga Trumpi. Por, qartazi, kjo nuk do të mjaftojë.

1. Presidentët Putin dhe Trump kanë zhvilluar në tre vjetët e fundit, jo me ndonjë koordinim dhe dije paraprake, një bashkëpunim intensiv në përcaktimin e identitetit evropian të shekullit XXI. Dhe, për këtë i kanë ftuar në ndihmë filozofët evropianë, Platonin, Fichten dhe Hegelin (e lista mund të jetë e gjatë deri në ditët e sotme).

Presidenti Putin me luftën e hapur pushtuese në Ukrainë, të filluar në shkurt të vitit 2022, ndikoi që popujt evropianë të ripërcaktojnë identitetin e tyre në saje të kundërshtisë. Evropa prej vitit 2022 e këtij po përpigjet të ndërtohet si kundërshti ndaj një veprimi të paprecedent prej vitit 1945, sulmit pushtues të një shteti ndaj shtetit tjetër evropian. Në këtë kuptim, Evropa prej vitit 2022 është duke u ndërtuar si një kundërshti ndaj politikës së Putinit, ndaj krejtësisht e kuptueshme që Suedia dhe Finlanda, shtete që ndërtuan një traditë të pranuar gjithandë prej shtetesh neutrale, të vendosnin të jenë anëtare të NATO-s. Presidenti Putin kështu zgjeroi pjesën evropiane të NATO-s dhe e begatoi me traditën e dy shteteve skandinave.

Presidenti Trump, duke paralajmëruar se SHBA-ja nuk do të mbajnë më përgjegjësi të sigurisë evropiane, e ka nxitur Evropën drejt përcaktimit të identitetit të vet në saje të kësaj kundërshtie të re. Kështu Evropa, që ia dha NATO-s edhe dy shtete të tjera anëtare, tash ballafaqohet me identitetin e ri, atij të konsideruarit të sigurisë së kontinentit eventualisht pa ombrellën mbrojtëse amerikane.

2. Nëse i pyesim filozofët evropianë – t'i thërrasim në ndihmë Platonin, Fichten dhe Hegelin – Evropa e sotme po përcaktohet për momentin me atë që nuk është, apo nuk dëshiron të jetë. Pra, nuk dëshiron të jetë një Evropë vulnerabël, në të cilën tanket ruse mund të hyjnë cilëndo prej ditëve që presidenti Putin përcakton se ky apo ai popull, apo ky apo ai shtet evropian, nuk ekziston a nuk duhet të ekzistojë. Dhe, njëkohësisht, nuk dëshiron të jetë një kontinent i cili duke përjetuar periudhën më të mirë të historisë, të një paqeje të pandërprerë gati 80 vjeçare (dhe këtu, me qëllim, harrohen luftërat e zhbërjes së ish-Jugosllavisë, si “joevropiane”) përnjëherë gjendet në një hapësirë të pasigurisë të krijuar nga kuptimi se marrëdhënies së deritanishme me Amerikën i ka ardhur fundi.

Platoni do të na mëson se “Njëshi”

# PUTINI, TRUMPI DHE PLATONI RIVIZATOJNË EVROPËN



nuk mund të ekzistojë pa “Tjetrin”, pra Evropa mund të kuptojë se çka është duke u ballafaquar me atë që nuk është, pra tradicionalisht nuk është me Rusinë, apo me atë që ka zbuluar tash se nuk është, Amerikën (transatlantike).

Johann Gottlieb Fichte argumentonte se “Unë” nuk mund të ekzistojë pa një “Jo-Unë” – një subjekt mund të kuptojë veten vetëm në raport me një kundërshtar apo sfidë. Evropa e sotme është intensivisht e Fichtes, kur po kupton se SHBA-ja nuk është më “fuqia më e madhe evropiane”, diçka që evropianët janë mësuar ta kenë si të mirëqenë. Dhe Hegeli na mëson tutje se identiteti evropian po ndërtohet në një dialektikë kundërshtish: interesi i SHBA-së jo domosdo është i përputhshëm me atë të Evropës dhe Evropa tash duhet të rizbulojë se si do të ndërtohet një përputhshmëri e interesash në një rend në të cilin Pax Americana (Paqja amerikane) nuk ekziston si paradhënie garancie bankare.

3. Tashmë është e qartë, në këtë fazë fillestare se çka është ajo që Evropa nuk dëshiron të jetë – një kontinent i pambrojtur dhe i ekspozuar ndaj agresionit rus apo i braktisur nga aleati i saj transatlantik. Nëse është kështu, atëherë kontinenti ka hyrë në një urgjencë vetëpërcaktimi që nuk është vetëm i natyrës ushtarake e gjeopolitike, por edhe filozofike dhe ekzistenciale. Kjo është

një Evropë që duhet ta definojë veten jo më si një projekt që mbështetet në premisën e paqes së përhershme dhe garancive të jashtme, por si një entitet që mund ta mbrojë dhe ta garantojë autonominë e tij.

Faza fillestare është ajo e përlloraritjeve ushtarake. Ish-kreu i Komisionit Evropian, Juncker, kërkoi që hapi i parë të jetë “përmirësimi i koordinimit të ushtrive evropiane dhe bashkimi i sigurisë – satelitët, inteligjenca artificiale në mbrojtje, kërcënimet kibernetike. Ne kemi 174 sisteme të ndryshme armatimi; SHBA-ja ka 34. Ne kemi më shumë se një duzinë automjetesh luftarake për këmbësorinë; SHBA-ja ka tre. Ne kemi një numër të panjohur tankesh të ndryshme; SHBA-ja ka një”.

Në këtë fazë fillestare është tani vëmendja e qytetarëve të shteteve të mëdha evropiane. Në një sondazh nga revista dhe think tank – u franco-evropian Le Grand Continent 50 për qind e të intervistuarve në Holandë dhe Belgjikë, 48 për qind në Francë dhe 43 për qind në Gjermani dhe Spanjë thonë se tani është urgjente që Bashkimi Evropian të rrisë shpenzimet për mbrojtje deri në 5 për qind të bruto prodhimit kombëtar.

Por, këto janë vetëm shenjat e para – dhe urgjente – të zgjimit.

4. Do të pasojnë pyetjet thelbësore. Për shembull, çka paraqet Evropa në kuptimin e një zone sigurie? Përgjigjja

evidente është hapësira që fillon në Britani të Madhe e përfundon në Turqi, përfshirë në këtë krah lindor edhe atë pjesë të Ukrainës që do ta kontrollojnë ukrainasit. Por, edhe këtu ka risi konceptuale: Kanadaja që tani do të dëshirojë të bëjë pjesë e bashkimit industrial për prodhimin e armëve. Dhe nëse do të mund të ishte Kanadaja (ndonëse një vend “evropian” në kontinentin amerikan) pse të mos ishin Koreja e Jugut dhe Japonia, që tashmë kanë zhvilluar bashkëpunimin me vendet anëtare të NATO-s?

I tërë kundrimi i një arkitekture të re të sigurisë qartazi kërkon kornizën e vet politike. Ajo mund të jetë kjo që është sot, NATO, aleanca më e fuqishme në historinë e njerëzimit, por tashmë me një rikontraktim të brendshëm, posaçërisht në marrëdhënien mes SHBA-së dhe Evropës. Mund të jetë edhe e një autonomie strategjike evropiane (ide e vjetër, që nga presidenti francez De Gaulle), sërisht brenda NATO-s. Mund të jetë e formave të reja inventive (të partneriteteve strategjike të mbrojtjes me shtete që nuk janë ende në NATO). Mund të jetë edhe diçka që ende nuk kemi dëgjuar.


Por, së fundmi, sfida themelore që do t'i paraqitet Evropës (prej Britanisë së Madhe deri në Turqi e Ukrainë) është se si të ndërtohet një zonë e përbashkët e sigurisë evropiane me përgjegjësi të plotë të shteteve evropiane?

Kjo është sfidë që tejkalon mendimin aktual në Bashkim Evropian, shtetet anëtare veç e veç dhe shteteve joanëtare si Britania e Madhe, Turqia apo në të ardhmen Ukraina, me potencial të theksuar në fushën e mbrojtjes.


Kjo është sfidë që po ashtu tejkalon institucionet e deritanishme evropiane politike e të sigurisë.

5. Vendet e Ballkanit Perëndimor gjenden tash në një moment historik analog në peshë me atë të vitit 1989, me rënien e Murit të Berlinit. Edhe asokohe u bë përcaktimi i identitetit me atë që ato vende nuk ishin apo nuk donin të ishin. Nuk ishin dhe nuk donin të ishin shtete komuniste dhe shumica prej tyre donin të ishin të pavarura. Që nga rënia e Murit të Berlinit është duke u zhvilluar lufta identitare e këtyre shteteve tashmë për atë se çka duan të jenë, supozohet shtete demokratike, funksionale e në paqe me fqinjët. Ky proces nuk ka përfunduar; ka ende shtete që nuk janë krejtësisht demokratike, funksionale apo në paqe me fqinjët.

Ndërkohë sfida e re është edhe një shkallë më e lartë, si ta gjejnë identitetin e tyre në një Evropë që vetë është shtyrë në sfidën e vet identitare. Mbase hapi i parë i kësaj hyrjeje në vetënjohje është identifikimi i problemit: si të jetojmë në një hapësirë të përbashkët sigurie.



## AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?



## AKOMA NUK JENI REGJISTRUAR NË GOOGLE?



Search Engine  
Marketing



Online  
Advertising



Social Media  
Marketing

**PËR ÇDO KONSULTIM  
MUND TË VINI  
NGA ZYRRAT TONA**



**020 7018 7929  
073 4066 5946  
078 5997 7545**



**ADRESA E ZYRAVE  
30 Avenons Road  
London E13 8HT**

# KROACIA: NISMA USHTARAKE ME SHQIPËRINË DHE KOSOVËN, E HAPUR EDHE PËR PARTNERËT

Nisma e Kosovës, Shqipërisë dhe Kroacisë për bashkëpunim në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, “është e hapur edhe për aleatë e partnerë të Bashkimit Evropian dhe NATO-s”, që “duan të kontribuojnë në ndërtimin e stabilitetit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë në rajonin e Evropës Juglindore”.

Kështu e komenton Qeveria e Kroacisë Deklaratën e nënshkruar nga tri vendet, më 18 mars.

Sipas saj, nismës mund t’i bashkohen të gjitha vendet që, po ashtu, duan t’i ofrojnë mbështetje Kosovës dhe Shqipërisë në rrugën e tyre evropiane dhe euroatlantike.

Qëllim i saj “nuk është krijimi i ndonjë aleance ushtarake”.

“Një aleancë e tillë - përveç anëtarësimit në NATO - as që është e nevojshme”, theksohet në përgjigjen me shkrim të Qeverisë kroate, dërguar Radios Evropa e Lirë.

Ndryshe nga Shqipëria dhe Kroacia, Kosova nuk është anëtare e NATO-s. Në reagimet e tij të para ndaj nismës, presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka thënë se me nënshkrimin e dokumentit, Kroacia, Shqipëria dhe Kosova “kanë hapur një garë armësh në rajon” dhe “kanë shkelur marrëveshjen nënrajonale të vitit 1996”.

Kjo marrëveshje, e cila ka të bëjë me kuotat e lejuara në armatim, u nënshkrua atëkohë nga dy entitetet e Bosnje e Hercegovinës - Federata e Bosnje e Hercegovinës dhe Republika Sërpska, si dhe nga Kroacia dhe nga Republika Federale e Jugosllavisë, e cila përbëhej nga Serbia dhe Mali i Zi. Në deklaratën dhënë Radios Evropa e Lirë, Qeveria kroate thotë se kjo marrëveshje është zbatuar vazhdimisht për 29 vjet.

Ajo, po ashtu, kujton se as Shqipëria dhe as Kosova nuk janë palë në atë marrëveshje.

“Në këtë kontekst, është krejtësisht e kotë të lidhet me Deklaratën e përbashkët, të nënshkruar së voni ndërmyjet Shqipërisë, Kroacisë dhe Kosovës, qëllimi kryesor i së cilës është forcimi i bashkëpunimit ndërmyjet ministrive të mbrojtjes të vendeve mike, partnerëve dhe aleatëve”, thuhet në reagimin e Qeverisë së Kroacisë.

Qeveria e Serbisë dhe Ministria e Mbrojtjes e këtij vendi nuk iu përgjigjën pyetjes së Radios Evropa e Lirë se përse e shohin si kërcënim nismën e tri vendeve ballkanike. Por, Daniel Serwer, profesor në Universitetin Johns Hopkins në SHBA, thotë se Beogradi zyrtar “e di fare mirë” se aleatët e NATO-s nuk mund të vepronin në mënyrë të njëanshme kundër Serbisë.



“Për më tepër, tri vendet e përmendura nuk paraqesin asnjë kërcënim për Serbinë”, thotë Serwer për Radios Evropa e Lirë.

Deklaratën e tri shteteve ai thotë se e sheh si “një lëvizje që kontribuon në stabilitet, jo në destabilizim”.

Ai vlerëson se Kosova ka vepruar “mençur” që ka lidhur partneritetet me Shqipërinë dhe Kroacinë, të cilat janë vende anëtare të NATO-s.

NATO-ja e komentoj gjithashtu Deklaratën, duke e cilësuar si marrëveshje trepalëshe mes tri vendeve.

“NATO-ja, si organizatë, nuk është pjesë e iniciativës dhe, për këtë arsye, nuk ka pasur ndonjë rol në procesin e konsultimit”, thuhet në përgjigjen dhënë Radios Evropa e Lirë.

Pse e pengon Beogradin? Vuk Vuksanoviq, studiues në Qendrën joqeveritare të Beogradit për Politikën e Sigurisë, thotë se zyrtarët në Beograd po e përdorin Deklaratën “për të larguar vëmendjen” nga problemet e brendshme.

Ai aludon te protestat masive që kanë përfshirë Serbinë për më shumë se katër muaj. Protestuesit, të udhëhequr nga studentët, kërkojnë përgjegjësi politike dhe penale për vdekjen e 16 personave nga shembja e një strehe në Stacionin Hekurudhor të Novi Sadit, nëntorin e kaluar.

Vuksanoviq thotë se Beogradi e konsideron pjesëmarrjen e Zagrebit si veçanërisht “provokuese”.

“Unë nuk mendoj se ka të bëjë aq shumë me Shqipërinë, marrë parasysh se Vuçiq ka, ose së paku ka pasur një

marrëdhënie mjaft bashkëpunuese me kryeministrin Edi Rama”, thotë ai. Megjithatë, për ministrin serb të Mbrojtjes, Bratislav Gashiq, memorandumit trepalësh është “një nismë provokuese e vendeve fqinje, që biesh me përpjekjet për forcimin e sigurisë rajonale”.

“Kosova dhe Metohia është një krahinë autonome brenda Republikës së Serbisë, pa marrë parasysh faktin se disa vende, përfshirë Shqipërinë dhe Kroacinë, e kanë njohur pavarësinë e saj të paligjshme dhe të vetëshpallur”, ka thënë Gashiq.

Kosova ka shpallur pavarësinë në vitin 2008, por ajo vazhdon të mos njihet nga Serbia.

Sipas Gashiqit, Zagrebi dhe Tirana ka kohë që përpriqen ta fusin Kosovën në NATO “përmes derës së pasme”.

Po sipas tij, këto dy vende po e ndihmojnë zhvillimin e Ushtrisë së Kosovës, të cilën Serbia e konsideron të paligjshme.

“Qartazi, një skenar i tillë nuk është i pranueshëm për vendin tonë”, ka thënë Gashiq.

Çfarë thuhet në Deklaratë? Deklarata për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë midis Shqipërisë, Kroacisë dhe Kosovës i ka katër pika.

E para i referohet promovimit të bashkëpunimit në industrinë e mbrojtjes - për të rritur gatishmërinë ushtarake.

Deklarata, gjithashtu, flet për përmirësimin e bashkëpunimit në fushën e arsimit dhe trajnimit të personelit

ushtarak, në përputhje me trajnimin dhe politikën e ushtrimeve në NATO dhe BE.

Një nga pikat e Deklaratës ka të bëjë edhe me shkëmbimin e informacioneve dhe të inteligjencës, si dhe me hulumtimin e mundësisë për t’iu përgjigjur një game të gjerë kërcënimesh të mundshme.

Aty theksohet, po ashtu, përputhja e politikës dhe qëndrimeve me ato të institucioneve euro-atlantike të sigurisë, si dhe detyrimi për të bashkëpunuar dhe për t’u koordinuar, me qëllim të integritit të plotë të Kosovës në nisimat rajonale të sigurisë.

Cila është forca ligjore e Deklaratës? Vuksanoviq thotë se kjo nuk është një marrëveshje tipike ndërshtetërore, sipas rregullave të së drejtës publike ndërkombëtare.

“Memorandumet për bashkëpunim nuk janë ligjërisht të detyrueshme në natyrë”, sipas tij.

Ai thekson se kjo është një marrëveshje nënrajonale midis dy anëtarëve të NATO-s me një palë të tretë - Kosovën.

Pjesëmarrjen e Kroacisë, ai e sheh si përpjekje për të arritur pikë politike në planin rajonal.

Kë e shohin si kërcënim Zagrebi, Tirana dhe Prishtina?

Në përgjigjen dhënë REL-it, Qeveria kroate thekson se bashkëpunimi në mbrojtje midis Zagrebit, Tiranës dhe Prishtinës është “i cilësisë së lartë” dhe se Deklarata ka synim vetëm ta përmirësojë atë.

“Zona e Evropës Juglindore është e

eksponuar ndaj kërcënimeve të sigurisë, veçanërisht atyre nga fusha hibride dhe kibernetike, qëllim i të cilave është destabilizimi i rajonit”, thuhet në Deklaratë.

Aty nuk specifikohet se nga vijnë kërcënimet. Kush është “faktor i paqes dhe stabilitetit” në rajon?

Përveç kundërshtimit të Deklaratës, zyrtarët serbë kanë përsëritur vazhdimisht se Beogradi mbetet i përkushtuar ndaj ruajtjes së paqes dhe stabilitetit rajonal.

Kështu, Ministria e Mbrojtjes e Serbisë ka thënë se, për këtë interes, do të vazhdojë të bashkëpunojë me vendet anëtare të NATO-s.

Por, profesori Serwer thotë se “gara e vetme” e armëve në rajon, është ajo që udhëheq Serbia për vite me radhë.

“Serbia nuk është faktor paqes dhe stabiliteti në rajon. Vuçiq, thjesht, i mashtrohet diplomatët naivë”, thotë ai.

Serwer shton se Beogradi vazhdon të refuzojë zbatimin e marrëveshjeve me Kosovën, si dhe t’i ofrojë mbështetje politikës secesioniste në Republikën Sërpska, të udhëhequr nga Millorad Dodik.

Po sipas tij, pushteti në Beograd, i cili nuk i ka ndërprerë lidhjet me Kremlinin as pas pushtimit rus të Ukrainës, inkurajon politika proruse si në Serbi, ashtu edhe në Mal të Zi.

“Asnjë nga këto nuk kontribuon në paqe dhe stabilitet”, përfundon Serwer.

Përgatiti: Valona Tela

# A DËSHIRONI TË BËHENI ELEKTRIÇIST I KUALIFIKUAR?

## A DËSHIRONI GOLD CARD?



**18 edition - Level 3 Award in the  
Requirements for Electrical  
Installations BS 7671:2018**

**EAL Level 3 Award in Electrical  
Installation Inspection,  
Testing, Certification and  
Reporting 603/2625/6**

**501/1605/8 Installing  
Electrotechnical Systems and  
Equipment NVQ**

**AM2 Assessment of  
Occupational Competence**



**[www.collegeoflondon.org.uk](http://www.collegeoflondon.org.uk)  
[info@collegeoflondon.org.uk](mailto:info@collegeoflondon.org.uk)**

